

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7864 E shtunë 27 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga BARBARA WESEL

Kapitull i ri për presidentin Macron



Më në fund Jupiteri zbriti nga maja. Le malit dhe dha një konferencë në Pallatin Elysée. Për herë të parë Emmanuel Macron doli para gazetarëve, u ul krejt normalisht...
Vijon në faqen 20

Opinion i Ditës

Nga VETON SURROI

A po ndodh një risi në botën shqiptare?



Ëmora të cituar nga shkrimi i një autori tjetër të botuar në "Koha Ditore" pikënisjen për këtë shkrim, njërin prej librave më me ndikim në debatin intelektual...
Vijon në faqen 21



Rrëfimi i bashkëpunëtorit të drejtësisë

Dëshmia e Alkond Bengasit: Ju tregoj bandën e Rinasit. "Daja" nga Kosova në pranga

Policia arreston të 6-tin, Ragip Hajdinin të "Shkëmbi i Kavajës". Roli i Klement Çalës

TIRANË-Më shumë se tri javë pas megagrabitjes në aeroportin e Rinasit, gazetarja Klodiana Lala ka mundur të sigurojë ekskluzivisht për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" dëshminë e plotë të Alkond Bengasit, bashkëpunëtorit të drejtësisë, i cili i rrëfeu Prokurorisë për Krime të Rënda gjithçka dinte rreth ngjarjes së ndodhur mesditën e 9 prillit, ku brenda pistës së aeroportit...
Në faqen 7

EMRAT/ KUSH MERR PARATE NE TIRANE, ELBASAN, FIER, VLORE DHE GJIROKASTER

KOMPENSIMI, SHPERNDAHEN 105 MLN LEKË PER PRONARET

Agjencia e Kadastrës përcakton masën e kompensimit financiar. Ndërtimet pa leje, marrin tapitë për truallin 1 mijë përfitues, ja sipërfaqja që legalizohet



(Në foto) Foto ilustruese

Në faqen 8-9

OPERACIONI

Vrasja e vëllezërve Bilali, dy në pranga. Policia: Emrat, kush qëlloi në Shkodër

Në faqen 6

MAXHORANCA

Valdrin Pjetri drejt Bashkisë Shkodër, Rama: Ai transformoi hipotekën e qytetit

Në faqen 3

PROTESTA

Teatrit Kombëtar i hiqet emri gjatë natës, artistët: Sjellje barbare

Në faqen 12

DOSSIER

Dr. Hasan Luçi: Si u krijua më 1914 qeveria e përkohshme vorio-epirote

Në faqen 10-11

OPOZITA



Protesta e 11 majit, Basha: Derë më derë për pjesëmarrjen. Çdo të enjte, bllokim rruge

Në faqen 2



Rrëfimi i ish-velinës: Pata shumë oferta. Kam kohë për gabime

Alesia Bami: Sfida ime e re si moderatore

Në brendësi: Edjon Hysenaj: Pasioni për aktrimin. Surpriza e Nik Xhelilaj

Nga PAMELA ALIAJ

Për pak kohësh u përfol shumë nëpër media ikja e saj si velinë e "Stop" në Klan TV. Por shumë shpejt modelja Alesia Bami u pa të ishte pjesë e emisionit të së dielës në "Top Channel", "E Diell". Jo vetëm kaq po shumë ndryshime të



tjera ndodhën me largimin nga pozicioni i velinës, duke marrë një rol të ri, atë të moderatores. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Alesia Bami na rrëfen prapaskanat e projektit të ri, surprizat që pret t'i ndajë...
Suplement

Suplement

PROTESTA OPOZITA

Kreu i PD: Brenda mandatit, paga minimale për mjekët 1200 euro, 700 euro për infermierët

Valentina Madani

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha mbledhi dje kryesinë e partisë dhe krerët e degëve ku në fokus ishte protesta e ardhshme e opozitës së bashkuar, e planifikuar për në 11 maj. Mësohet se z.Basha kërkoi një pjesëmarrje sa më të lartë në protestën e radhës ndërkohë që ish-deputetët do të zbrisin në bazë për të takuar qytetarët në mbarë vendin. "Sa më shumë pjesëmarrje në protestë. Të shkohet në çdo derë për të përcjellë mesazhin se Edi Rama duket larguar", deklaroi z.Basha. Gjatë mbledhjes u vendos që çdo të enjte do të bllokohen rrugët në të gjithë Shqipërisë. Gjithashtu, mësohet se do të bllokohen rrugët edhe në qytetet ku kryeministri Rama do të zhvillojë turin e tij në kuadër të "Bashkia që duam". Bllokimi i rrugëve nisi ditën e djeshme në qytetin e Shkodrës, për të vijuar ditën e nesërme në qytetin e Elbasanit. Ndërkohë, dy ditë më parë u bllokuan përreth një orë pesë akset kryesore në vend. Në Tiranë, rrethrotullimi Shqiponja; Durrës-Kavajë; Plepa Autostradë-përbalje shtëpisë së pushimit; Fier, rrethrotullimi Sheq; Elbasan, rrethrotullimi Bradashesh; Milot, karburanti në autostradë.

PREZANTIMI

Më herët kreu i opozitës, Lulzim Basha, prezantoi dje pikat kryesore të programit të PD-së për shëndetësinë. I ftuar në konferencën "Sistemet shëndetësore, vizione dhe sfida", e organizuar nga Fondacioni "Konrad Adenauer", z.Basha premtoi se brenda 4-vjeçarit të parë të qeverisjes demokratike paga minimale për mjekët do të arrijë në 1200 euro në muaj dhe paga minimale për infermierët do të arrijë 700 euro në muaj. z.Basha theksoi se investimi në burimet njerëzore në shëndetësi është prioritet absolut i hapave emergjentë, që do të ndër-marrë PD sapo të ketë votëbesimin për të qeverisur vendin. "Pa një ndryshim themelor të politikës së pagave nuk do të sjellim dot asnjë sprapsje të zbrazjes së sistemit shëndetësor dhe spitalëve tona nga mjekët, të largimit të studentëve të mjekësisë drejt Gjermanisë dhe vendeve të tjera të BE, të kolapsit të shërbimit të infermierisë" - u shpreh z.Basha.

PREMTIMI

Për kreun e opozitës, Lulzim Basha pjesë kyçe e programit të PD-së është rritja e ndeshme e pagave në sistemin e shëndetësisë. "Dua të deklaroh nga kjo konferencë vendimin dhe

Protesta e 11 majit, Basha: Derë më derë për pjesëmarrjen më të lartë Vendimi, çdo të enjte bllokim rrugësh



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

HENZE

Deputeti i CDU-së, Martin Henze, i cili po asiston PD në hartimin e programit, deklaroi: "Ju në Shqipëri duhet të keni një ligj të posaçëm për PPP-të. Rekomandimi ynë është që të respektohen kriteret e BE-së që të mos krijohen monopole. Koncesionari i 'check up' në Shqipëri ka krijuar monopol dhe kjo ka sjellë ndikim negativ në cilësi", - tha Henze

MANASTIRLIU

"Kur flet për shëndetësinë në gjendje kome, ka parasysh gërmadhat që la pas qeveria e tij, apo 80 qendrat shëndetësore ku qytetarët shqiptarë kanë filluar tashmë të marrin shërbime cilësore dhe me standarde, të cilat deri në fund të mandatit, do të bëhen 300", - deklaroi ministria e Shëndetësisë.



Një nga protestat e opozitës

"Gati për zgjedhjet, parlamentarët janë shumë afër"

Kryemadhi, mesazh Ramës: LSI nuk është më e Metës, e qetësisë dhe dashurisë

Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi zhvilloi dje një takim me ambasadorin e BE-së në Tiranë, Luigi Soreca. Takimi që u zhvillua në selinë e LSI, kishte në fokus situatën politike në vend. Kurse nga mbledhja e Komitetit Drejtues Kombëtar të LSI, ajo i dha një mesazh kreut të qeverisë, Edi Ramës. "Meqë ka merak të madh për LSI, po ia bëj të qartë që LSI nuk është më e kohës kur kishte Ilir Metën që kishte hallin e stabilitetit të të dashurisë dhe qetësisë. Dashuri dhe qetësi me kriminelin ka mbaruar, nuk ka me atë njeri që ka veshur me të zeza nënat e shqiptarëve. Rama të mos guxojë të cenojë asgjë të shqiptarëve se nuk do ketë përbalje lig-



jore, por personale se nuk ka për ta falur asnjë të ardhmen e fëmijëve", theksoi zj.Kryemadhi. Ajo bëri të qartë se opozita vazhdon t'i qëndrojë kërkesave të saj për një qeveri tranzitore, ndërsa shtoi se marrëveshja e firmosur pak ditë më parë me PD dhe aleatët, është një marrëveshje që ka bërë bashkë 60% të votuesve. "Faktorit ndërkombëtarë tona kemi bërë të qartë dhe jemi të palëkundur në kërkesat tona. Sa i takon angazhimeve tona, të LSI, do të

jemi në kontakt të vazhdueshëm me njëri-tjetrin, do të jetë e pandalshme, jo për takime e meetinge, por për t'u takuar me njerëzit. Njerëzit e LSI duhet të zgjohen, jo për ta bindur njëri-tjetrin, por të takojnë njerëzit, që nuk e dinë rolin e LSI në 8 vite qeverisje dhe se çfarë kanë bërë", tha kryetarja e LSI. Kryemadhi shtoi: "Ne do të marrim vendim edhe për mbledhjen e Konventës Kombëtare të LSI. Pas zgjedhjeve parlamentare, që do të jenë shumë shpejt, meqë kishte merakun e fallit Edi Rama. Çdo strukturë partiake e të 12 qarqeve do të futet në procesin "një anëtar një votë" për zgjedhjen jo vetëm të kandidatëve për deputetë, por edhe për këshillat bashkiakë".

AKUZAT

Pasi radhiti problemet e rritja e ndeshme e numrit të studentëve që diplomohen në mjekësi, duke i kushtuar vëmendje rritjes së numrit të specializimeve dhe kualifikimeve, ngritjeve profesionale të pandërprerë, trajnimeve dhe garantimit të kushteve të punës.

AKUZAT

Pasi radhiti problemet e

Akuza për falsifikim, BD e Patozit me firmëtarë fiktivë, 4 qytetarë ankime në gjykatë

Tri ditë më parë, Astrit Patozi, deklaroi se kishte dorë zuar në gjykatë dokumentacionin për krijimin e forcës më të re politike në vend, me emrin Bindja Demokratike. Sipas Patozi janë rreth 4 mijë qytetarë që kanë firmosur me vullnetin e tyre për të themeluar Bindjen Demokratike. Por 'News 24' zbuloi dje se me dokumentacionin e dorëzuar në gjykatë disa nga firmëtarët janë fiktivë. Një ndër ta, Dritan Agushi nga qyteti i Kavajës i kontaktuar nga 'News24' deklaroi se ishte vënë në djepin nga familjarët që emri i tij ishte në listën e theme-luesve. Ai thotë se ndodhet jashtë vendit dhe se firma e tij është falsifikuar, madje prenton se do ta ndjekë ligjërisht çështjen. Por historia me falsifikim firmash nuk mbaron me kaq. Disa qytetarë të tjerë, po nga Kavaja, kanë bërë ankime në gjykatë kundër Bindjes Demokratike, duke e akuzuar se ka përdorur firmat e tyre për themelimin e partisë. Paddia që disponon 'News 24', është firmosur nga Zyber Molla, Shyqyri Proshka, Mehmet Sheme dhe Mirjan Krasniqi. Qytetarët që kanë verifikuar falsifikimin e dokumenteve akuzojnë gjykatën për shkelje të ligjit, pasi sipas tyre ka bërë regjistrimin e Bindjes Demokratike pa verifikuar firmat. Të katërt qytetarët, që i kërkojnë gjykatës të kthejë mbrapsht si të paligjshëm vendimin për regjistrimin e Bindjes Demokratike, shprehin gatishmërinë e tyre të vendosin para gjykatës specifikimet e shkrimit të tyre për të verifikuar shkencërisht si firmat për regjistrimin e Bindjes Demokratike janë falsifikuar.

sistemit shëndetësor, lideri demokrat Lulzim Basha e krahasoi Shqipërinë me vendet e Afrikës. Në takimin rajonal për vizionin dhe sfidat e shëndetësisë, kreu i PD-së akuzoi qeverinë se po e shkatërron këtë sektor me anë të PPP-ve korruptive dhe të pakontrolluara, dhe si rezultat i kësaj sipas

kreut të PD pacientët po konsumojnë ilaçe të skeepuara. "I në 10 ilaçe sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë bën pjesë në industrinë e fake-drugs. Një vit para se qeveria Rama t'i hapte derën kanabisit, pastaj heroinës dhe kokainës, i hapi derën mafias farmaceutike", - theksoi kreu i PD-së.



Ish-ministri ka kritikuar largimin e Drejtorisë Arsimore

Bushati: Përgjegjësia për gjendjen ku ndodhet Shkodra, edhe e qeverisë

Ish-ministri i Jashtëm Ditmir Bushati çdo ditë e më shumë po shfaqet si një zë kundërshtues brenda mazhorancës. Pas disa komenteve të tija publike ku nuk ka nguruar të shpreh kritik për situatën në të cilën ndodhet vendi, Bushati nuk i ka kursyer kritikën për qeverinë as për gjendjen në të cilën ndodhet sot Shkodra. Sipas tij përveç PD-së, përgjegjësia për Shkodrën i takon edhe qeverisë dhe të zgjedhurve socialistë. "Shkodra që duam është shumë larg Shkodrës që është sot dhe këtu nuk diskutohet që përgjegjësinë ekskluzive e ka PD. Por edhe ne kemi përgjegjësi të tona, grupi i deputetëve, qeveria jonë, përfaqësuesit tanë në pushtet vendor. Nuk jemi të kënaqur me atë çfarë kemi bërë për Shkodrën për rindien urbane. Në çdo familje ndjehet një tërësi kërkesë,



nevojën dramatike për më shumë investime", - tha Bushati. Më tej ai sollti në vëmendje edhe pakënaqësinë që ka krijuar të shkodranët vendim për të hequr nga ky qytet, djep i kulturës dhe arsimit, Drejtorinë Rajonale Arsimore dhe për ta çuar në Lezhë. "Është përgjegjësia jonë që disa çështje sensitive që kanë të bëjnë me traditën e këtij qyteti ndoshta ne duhet t'i kemi më mirë në konsideratë. Shumë më kanë shkruar, më kanë folur për transferimin e

drejtorisë arsimore rajonale nga Shkodra në Lezhë. Shkodra gjithmonë ka qenë mikpritëse për qytetarët nga do që ato vinin. Ishte Luigj Gurakuqi ministri i parë i Arsimit. Ishte Shkodra që i dha vendit një institut që më pas u shndërrua në universitet. Janë këto lloj shqetësimesh që kanë lidhje me traditën e konsoliduar të këtij qyteti shpesh na bëjnë që të gjykojmë herë-herë të dukemi sikur gjykojmë edhe ngushtë", - tha Bushati.

KRIZA POLITIKE, META TRYEZË ME KRERËT E PARTIVE TË VOGLA

Presidenti Ilir Meta do të takojë partitë e vogla. Takimi pritet të mbahet të martën në orën 11:00 dhe vjen pas kërkesës së këtyre partive për një tryezë. Pesë kryetarët e partive të grupimit të qendrës së djathtë PR, LZHK, PPA, PBDNJ dhe PDK, të cilët nuk janë regjistruar për zgjedhjet e 30 qershorit, zhvilluan të njëjten një takim me ambasadorin evropian në vendin tonë Luigi Soreca. Pas takimit me Sorecan Mediu tha: Ne do t'i kërkojmë Presidentit të Republikës që të thërrasë një tryezë të pozitës dhe opozitës për të zgjidhur këtë situatë për të garantuar zgjedhjet të lira dhe të ndershme. Çdo gjë tjetër do të ishte shkatërruese për vendin. Soreca dhe të gjithë janë në mbështetje të dialogut.

Kreu i qeverisë konfirmoi se zgjedhjet vendore do të mbahen në 30 qershor

Pjetri drejt Bashkisë së Shkodrës, Rama: Transformoi hipotekën

"O Lul, s'do të të jap pjeshka dhe karamela në çdo zgjedhje"



Kryeministri Edi Rama gjatë takimit dje në Shkodër

Ish-drejtori i Përgjithshëm i Hipotekës, Valdrin Pjetri duket se do të jetë kandidati i Partisë Socialiste për kryetar të Bashkisë së Shkodrës. Ndonëse nuk e shpalli publikisht, kryeministri Edi Rama gjatë takimit që zhvilloi në Shkodër në vijim të turit "Bashkia që duam", la të kuptohet qartë se Pjetri që tashmë mban detyrën e Prefektit të Shkodrës, do të përfaqësojë mazhorancën në zgjedhjet e ardhshme vendore për të fituar për herë të parë Bashkinë e Shkodrës. Rama foli me superlativa për të duke theksuar se kishte bërë një punë shumë të mirë në krye të hipotekës. "Edhe këtu në Shkodër ne kemi shumë nevojë që të bëjmë më shumë më tepër për zyrat e shërbimeve. Dhe një nga arsytet që unë i kam kërkuar Valdrinit që të vijë këtu është pikërisht kjo. E kam njohur nga puna e jashtëzakonshme që ka bërë më parë, por sidomos në drejtimin e hipotekës dhe nga transformimi që i ka bërë punëve në hipotekë dhe i thash që ti do shkosh atje Prefekt dhe duhet të bësh çmos që në radhë të parë njerëzit në Shkodër pavarësisht bindjeve, pavarësisht lekëve të trajtohen me dinjitet në zyrat e shtetit", - tha Rama në fjalën e tij. Natyrisht ajo që forcon edhe më shumë mundësinë që Valdrin Pjetri të jetë kandidat për kryetar të Bashkisë së Shkodrës, është edhe fakti që ai ishte zgjedhur që të përshëndeste këtë takim, krahas Ramës dhe drejtuesit politik të qarkut, Ditmir Bushati. Pjetri në këtë mënyrë duket se ka mundur kandidaturën

e Senida Mesit, e cila deri më tani ishte përfolur si kandidatë e sigurte e PS-së për këtë bashki. Ndërkohë që edhe nga Shkodra kreu i qeverisë Edi Rama ka konfirmuar edhe një herë qëndrimin e mazhorancës për të mos lëshuar asgjë sa i përket shtyrjes së zgjedhjeve vendore dhe kërkesës së opozitës për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare

nëpërmjet një qeverie tranzitore. Ai u shpreh i prerë se nuk ka asnjë mundësi që zgjedhjet lokale të shtyhen, duke theksuar se në 30 qershor socialistët do të fitojnë për herë të parë edhe Bashkinë e Shkodrës. "Zgjedhjet janë në 30 qershor. Ata nuk u regjistruan në zgjedhje, por në 30 qershor do marrim Bashkinë e Shkodrës. Demokratëve të mërzitur u them

7 kandidatë të pavarur për zgjedhjet lokale, mes tyre ish-deputeti i PD

Shtohet lista e kandidatëve të pavarur që kanë nisur procedurën për t'u regjistruar për zgjedhjet për kryetar bashkie. Deri më tani numri ka shkuar në 7 dhe mes tyre nuk mungojnë edhe emra të njohur. Kështu, burime nga KQZ kanë bërë të ditur se interes për garën ka shfaqur edhe ish-deputeti demokrat, Bedri Hoxha, i cili kërkon të kandidojë për Bashkinë e Klosit. Ndërkohë që në Bashkinë Sarandë është regjistruar komiteti nismëtar për të mbledhur firma për kandidatin Ilir Nikolla, ndërsa në Himarë ka nisur procedurën Fredi Beleri. Ndërkohë që në Kurbin ka nisur procedurën Nikoll Lleshi, në Berat Plarent Aleksi dhe në Devoll dhe Fezi Shaholli në Devoll. Kandidati i shtatë i pavarur është Fran Molla si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Tiranë.

ruani gomat që mos t'ua marrim Flamur t'ua djegë. S'ka filxhan që e përmbys fatin e zgjedhjeve që i shkruan populli me votën e vet", u shpreh Rama. Gjithashtu, ai ka hedhur poshtë çdo mundësi që mes tij dhe kreut të opozitës të ketë një tjetër marrëveshje si ajo e 2017 për t'i dhënë fund krizës. "Dy vjet si sot Lul m'u fut në çadër poshtë penxhres. Vinte më

këndonte himnin që në mëngjes, mbante fjalimin, më pas ikte flinte gjumë, ata birra... U dorëzuan amerikanët, evropianët, vetëm unë jo, ç'kam heq duke u lutur, nuk u jam lutur të gjithë njerëzve, sa i jam lutur atij. I thashë merr çfarë do ti, vetëm mua mos më kërko se jam i martuar. Tani prapë e njëjta histori? O Lul po pse ca do të jap unë pjeshkat dhe karamela

KANDIDATI
"Një nga arsytet që unë i kam kërkuar Valdrinit që të vijë këtu është pikërisht kjo. E kam njohur nga puna e jashtëzakonshme që ka bërë më parë, por sidomos në drejtimin e hipotekës dhe nga transformimi që u ka bërë punëve në hipotekë dhe i thash që t'i do shkosh atje prefekt dhe duhet të bësh çmos që në radhë të parë njerëzit në Shkodër pavarësisht bindjeve, pavarësisht lekëve të trajtohen me dinjitet në zyrat e shtetit", - tha Rama

let sa herë vijnë zgjedhjet", u shpreh kryeministri. Në fjalën e tij ai ka sulmuar PD-në, e cila sipas tij ka tradhtuar shkodranët duke i zëvendësuar Jozefina Topallin me Flamur Nokën. "Nga Jozefina Topalli kanë kaluar te Flamur Noka. Kur përballësh me Jozefina Topallin përballësh me një kundërshtar, por kur përballësh me Flamurin ke përpara një hu që nuk ka fermer që e përdor për gadhin e vet. Mund të ketë shumë fermerë demokratë që mund t'i shkojnë prapa Flamurit, por po ti thashë merr dot për hu për gadhin tënd, nuk e merr, nuk e merr; sepse i rrezon gadhin" tha Rama. Si mund të vijë puna që ti vihet në ballë Shkodrës Flamur Noka. Si mund të katandiset kjo puna që Shkodra demokratë të djegë goma nën udhëheqjen e Flamur Nokës. E shikoni sa ka rënë pazari, ku ka shkuar pazari, në tokë", - tha Rama.

KRIZA POLITIKE ZGJIDHJA

Deputeti Petry: Djegia e mandateve e pakuptueshme, palët të gjejnë zgjidhjen

Valentina Madani

Christian Petry, deputeti socialdemokrat gjerman që kryeson Komisionin e Çështjeve të BE në Bundestag, pas një vizite 2-ditore në Tiranë, ku takoi përfaqësues të maxhorancës e opozitës është i paqartë, si një forcë politike si PD mund të dalë nga parlamenti duke djegur mandatet. Deputeti i Bundestagut i bëri thirrje PD-së dhe aleatëve të saj që të mos i bojkotojnë zgjedhjet e 30 qershorit. Teksa e cilësoi si të gabuar djegien e mandateve nga ana e opozitës, në një deklaratë për mediat nga ambasada gjermane në Tiranë, deputeti gjerman theksoi se ka ardhur koha që palët të nisin dialogun dhe t'i japin fund krizës politike. "Djegia e mandateve është hap i gabuar nga opozita. PD të futet në zgjedhjet e 30 qershorit. Qeveria dhe opozita të dialogojnë", deklaroi z.Petry. Në një bashkëbisedim me gazetarët, ai u shpreh se nuk kupton qartë dhe akuzat që e çuan opozitën drejt kësaj vendimmarrje. I pyetur mbi legjitimitetin e zgjedhjeve, nëse opozita nuk merr pjesë në garën e 30 qershorit, Petry nuk e artikulon prerë qëndrimin e tij, por shprehet se çdo forcë merr vendimet e saj. Megjithatë sipas tij, nëse demokratët do të ishin pjesë e tyre do të kishin mundësi që të bënin të vlefshme akuzat e tyre ndaj qeverisë. Madje, pas takimeve me krenun e shtetit Ilir Meta, kryetarin e grupit parlamentar, Taulant Balla, kryedemokratit, Lulzim Basha dhe me përfaqësues të sho-

Kriza, Bundestagu gjerman thirrje për dialog: PD të hyjë në zgjedhje

Negociatat, Balla: Ka një shumicë mbështetëse



Christian Petry, deputeti socialdemokrat gjerman, që kryeson Komisionin e Çështjeve të BE në Bundestag

qërisë civile, ai bëri thirrje për dialog dhe për pjesëmarrje në zgjedhje. "Të gjithë përfaqësuesit e politikës duhet të gjejnë një rrugë për zgjidhje përmes dialogut. Jam njohur me situatën politike të Shqipërisë dhe për mua është e vështirë të kuptoj vendime si dalja nga parlamenti. Si parlamentar, gjykoj se ky vendim është i pasaktë pasi sjell shmangien nga procedurat demokratike dhe përdorimin e instrumenteve jashtëparlamentare", theksoi deputeti i Bundestagut.

Europuteti i së majtës gjermane, Christian Petry dha notë pozitive për çeljen e negociatave, por theksoi se mbetet shumë për të bërë në luftën ndaj kimit të organizuar dhe drogës. "Pas informimit për ecurinë e reformës në drejtësi dhe ndërtimin e shtetit ligjor, unë do të kem vendimmarrje pozitive për çeljen e negociatave. Megjithatë, konfirmoj se në sektorë të ndryshëm mbetet ende shumë punë për të bërë, kryesisht në luftën kundër kimit të organizuar dhe drogës", de-

klaro z.Petry. Edhe kreu i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, nënvizoi se nga Gjermania do të ketë votë pro për çeljen e negociatave të integritetit të Shqipërisë. "Ka një shumicë mbështetëse, inkurajuese për gjithçka ka arritur Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut", deklaroi z.Balla. Vizita e deputetit gjerman vjen në kohën kur opozita ka deklaruar se nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet e qershorit pa krijimin e një qeverie tranzitore, por që për mazhorancën ky është

CHRISTIAN PETRY

"Të gjithë përfaqësuesit e politikës duhet të gjejnë një rrugë për zgjidhje përmes dialogut. Jam njohur me situatën politike të Shqipërisë dhe për mua është e vështirë të kuptoj vendime si dalja nga parlamenti. Si parlamentar, gjykoj se ky vendim është i pasaktë, pasi sjell shmangien nga procedurat demokratike dhe përdorimin e instrumenteve jashtëparlamentare", theksoi deputeti i Bundestagut.

BE, Soreca: Godisni, korrupsioni është hajduti i qytetarëve shqiptarë

Ambasadori i Bashkimit Europian në Tiranë shprehu dje domosdoshmërinë e luftës kundër korrupsionit, si një ndër prioritetet kryesore. Luigi Soreca tha se ka ende shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim, pas korrupsionit prek funksionarët e administratës publike, dhe kjo është kosto për Shqipërinë. "Lufta kundër korrupsionit është e rëndësishme edhe për popullsinë, reputacionin dhe zhvillimin ekonomik. Kostoja që paguan ekonomia është shumë e madhe, por kostoja e shoqërisë edhe më e madhe, sepse korrupsioni prek funksionarët e administratës publike dhe cilësinë e shërbimit. Në terma konkret kjo do të thotë më pak shkolle, spitale dhe punë. Korrupsioni është hajduti i qytetarëve shqiptarë", deklaroi z. Luigi Soreca. Teksa shprehu edhe mbështetjen e BE, Soreca nënvizoi se çrënjosja e korrupsionit kërkon edhe vullnet politik. "Ka pasur shumë sfida gjatë rrugës, duke nisur nga stafi i limituar deri te zgjedhjet e përgjithshme apo rikonstruktimi i qeverisë. Por sfida më e madhe mbetet çrënjosja e korrupsionit, sepse kjo kërkon vullnet politik, por dhe vendosmëri për ata që janë viktimat si qytetarët apo studentët", theksoi ambasadori Soreca. Këto deklarata ambasadori i bëri në takimin përmblylës të projektit të binjakëzimit të BE kundër korrupsionit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje një pajisje UPS për nevojat e një 'Server Room' të Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,700,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje një pajisje UPS për nevojat e një 'Server Room' të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 17 Maj 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,660,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi 3-vjeçar i mirëmbajtjes dhe riparimit të motogeneratorëve dhe stabilizatorëve të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 17 Maj 2019, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

MBZHR: Zero tolerancë, kanë nisur kontrollet në terren për rastet e abuzimeve

Voltiza Duro

Lidhur me sigurinë ushqimore në vend nuk ka vend për alarm. Deklarata është bërë ditën e djeshme nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila ka reaguar publikisht pas akuzave për përdorim pesticidesh nga ana e fermerëve. Institucioni ka theksuar se tregu shqiptar ofron produkte të sigurta, brenda standardeve. "Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural informon qytetarët se nuk ka vend për alarm. Sot në tregjet shqiptare ka produkte ushqimore të sigurta dhe të certifikuara sipas standardeve të sigurisë ushqimore, të garantuara me ligj dhe akte rregullatore", - bën me dije ministria.

MASAT PËR ABUZIMET

Ministria më tej ka theksuar se toleranca do të jetë zero për të gjithë ata që abuzojnë dhe shkelin standardet e sigurisë së produkteve. "Nuk do të ketë tolerancë ndaj askujt që abuzon me ushqimet dhe jemi të vendosur për të zbatuar me rigorozitet ligjin në çdo rast që konstatohet se është cenuar siguria ushqimore. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka nisur menjëherë verifikimet dhe kontrollet në terren për rastet e denoncuar në media. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të gjitha institucionet e varësive

Siguria ushqimore, Ministria e Bujqësisë: S'ka vend për alarm

"Produktet janë të sigurta e të certifikuara"



mbeten të vendosura për t'i shkuar deri në fund çdo rasti abuziv të konstatuar. Njëkohësisht inkurajon prokurorin të çojë përpara hetimet dhe të vendosë përpara ligjit këdo që cenon sigurinë ushqimore", -

thekson MBZHR. Kjo e fundit bën me dije gjithashtu se institucionet përkatëse monitorojnë dhe raportojnë mbi sigurinë e prodhimeve vendëse, si dhe kanë marrë masat përkatëse ndaj çdo rasti abuzimi

që kanë zbuluar deri në pezullim të aktivitetit prodhues të subjekteve që kanë kryer shkelje të ligjeve dhe standardeve në fuqi. "Prodhimet bujqësore shqiptare konkurrojnë sot në tregjet ndërkombëtare. Shqipëria është një nga vendet kryesore të eksportit të prodhimeve bujqësore në rajon, ndërsa janë rritur ndjeshëm eksportet drejt vendeve të BE-së. Kjo rritje e eksporteve të prodhimeve vendëse dëshmon se fermerët shqiptarë ofrojnë produkte të cilësisë së lartë dhe të sigurta. Deri më tani nuk ka pasur kthime mbrapsht të prodhimeve bujqësore nga Shqipëria, për shkak të treguesve të sigurisë ushqimore që lidhen me nivelin e pranisë së pesticideve", - nënvizon ministria. Kjo e fundit është ndalur edhe në importin e produkteve bimë dhe shtazore, specifiktisht importin e mishit të gje-

Karta e studentit, gati në maj për studentët e Tiranës

Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe atë të Kulturës kanë nisur prodhimin e kartës së studentit, e cila do të shpërndahet gjatë muajit maj. Kryebashkiaku Erion Veliaj dhe Ministria e Kulturës, Elva Margariti zhvilluan dje një dëgjësje me studentë që ndjekin studimet e larta në Tiranë, ku njoftuan disa nga mundësitë dhe lehtësitat që do të ofrojë karta e studentit, për më shumë se 40 shërbime, muzeume apo biblioteka. Veliaj vlerësoi punën e bërë me plotësimin e pikave të Paktit për Universitetin dhe tha se karta e studentit ka nisur të prodhohet si dokument, ndaj brenda këtij sezoni universitar do të shpërndahet për gjithë studentët që mësojnë në universitetet e Tiranës.

dhit, dërrit dhe shpendit nga Brazili, ku ka theksuar se që prej 2017-ës ushtrohen kontrolle në masën 100% të ngarkesave të ardhura. Ministria ka bërë me dije gjithashtu se edhe stabilimentet e përpunimit të qumështit janë të pajisura me certifikata ndërkombëtare të sigurisë.



NJOFTIMI I ANKANDIT

- Autoriteti Shitës:** Albpetrol Sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7.
- Data e zhvillimit të ankandit:** 03.05.2019, ora 11:00.
- Lloji i Procedurës të ankandit:** Procedure e hapur.
- Objekti i Shitjes:** Shitje nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Afati i evadimit:** 270 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:** Shitje e nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Vlera fillestare:**

Ne kushtet FOB:

Çmimi minimal fillestar per njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent + K**Në pikat e lëvrimit:**

Çmimi minimal fillestar për njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent – 2.97 USD/bbl + K

- 75.27 % është koeficienti i cili përfaqëson karakteristikat mesatare të naftës (peshat specifike, aciditeti i naftës, % e squfurit).
- Brent është çmimi në \$/bbl i Brent i Platts, i publikuar në Buletinim të Prokurimit Publik.
- 2.97 USD/bbl kosto mesatare totale (transport, magazinim, stokim, analizim produkti, sigurim).

- K- është vlera \$/bbl e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal të shitjes të përlogaritur nga formula (Ke⁰).

- Vendndodhja e naftës brut: Albpetrol sha Patos:** Ne pikat e levrimit Stacioni Usoje, Stacioni Visoke, Stacioni Gorisht, Stacioni Zharrez, Stacioni Kuçove, Stacioni Amonice.
- Vendi i zhvillimit të ankandit:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.
- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:** në zyrën e protokollit Kati 1 tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 03.05.2019, ora 11:00.
- Data e hapjes së ofertave:** datë 03.05.2019, ora 11:00, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.

- Informacion mbi dokumentet e ankandit:** Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës me paraqitjen e një kërkesë me shkrim ose në faqen zyrtare të "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë www.infrastruktura.gov.al.

Dokumente me pagesë:

Po Jo

- Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, përpara datës dhe orës së zhvillimit të ankandit, në vendin e përcaktuar në dokumentat e ankandit.**

Policia: I kërkuari Ibrahim Lici, autori u vrasjes së dyfishtë të 30 marsit

SHKODËR

Afro një muaj pas ekzekutimit me breshëri kallashnikovi të vëllezërve Astrit dhe Brahim Bilali, përkatësisht 59 dhe 61 vjeç, është zbardhur ngjarja e rëndë që tronditi qytetin verior. Në lidhje me atentatin e ndodhur më 30 mars në lagjen "Kiras" (afër banesave të viktimave) dhe ku morën pjesë katër persona, janë arrestuar dy prej tyre, ndërsa janë shpallur në kërkim dy të tjerë. Njëri nga personat në kërkim, dhe konkretisht Ibrahim Lici, dyshohet të jetë autori vrasjes së dyfishtë. Viktima Brahim Bilali ishte drejtues i shoqatës "2 Prilli 1992", ndërsa vëllai i tij, Astriti, ishte kampion i garave të hipizmit. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së garkut të Shkodrës dje bënë me dije se gjatë operacionit të koduar "Livadhe" u prangosën shtetasit Arsen Stojku 29 vjeç dhe Mislum Rama 23 vjeç, të dy banues në fshatin Mjedë të Vaut të Dejës. Dy të rinjtë arrestuan nga blutë me urdhër të prokurorisë lëshuar më 25 prill. Të dy akuzohen për vrasje me paramendim, kryer në bashkëpunim dhe prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit. Ndërkohë, në kërkim është shpallur edhe një 29-vjeçar me inicialet D.B., i cili dyshohet të ketë përkrahur autorin e krimin në arratisje. Nga hetimet e kryera rezultuan se personat e mësipërm kanë planifikuar, organizuar dhe kryer në bashkëpunim atentatin ku mbetën të vrarë dy vëllezërit Bilali. Viktima Astrit Bilali është babai i Astmer Bilali, i arrestuar si pjesë e grupit "Bajri" në Shkodër, ndërkohë që grupi kundërshtar i tyre janë Licët. Dyshohet që pikërisht lufta mes këtyre bandave të ketë sjellë viktimat e radhës në këtë përplasje. Gjithashtu, mësohet se operacioni është zhvilluar me metoda speciale të hetimit nga DVP Shkodër, Drejtoria për Krimet e Rënda në Departamentin e Policisë Kriminale, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Për zbardhjen e ngjarjes nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit u ngrit një grup i posaçëm hetimor në bashkëpunim me DVP Shkodër dhe nën drejtimin e Prokurorisë Shkodër.

OPERACIONI

Si rezultat i një pune të mirorganizuar nga ana e DVP Shkodër, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me mbështetjen e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale në Policinë e Shtetit, u zhvillua operacioni policor i koduar "Livadhe", i cili u finalizua me ekzekutimin e urdhrave të ndalimit, datë 25.04.2019, të lëshuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës

Atentati ndaj dy vëllezërve Bilali, arrestohen dy persona, në kërkim ekzekutori dhe një tjetër

Operacioni i koduar "Livadhe", në pranga të rinjtë Arsen Stojku dhe Mislum Rama nga fshati Mjedë



Dy të arrestuarit për vrasjen e dyfishtë, Arsen Stojku dhe Mislum Rama



Vëllezërit e vrarë në atentat, Astrit dhe Brahim Bilali

REAGIMI I MINISTRIT LLESHAJ

Pas arrestimit të dy personave si dhe shpalljes në kërkim të dy të tjerëve në lidhje me vrasjen e vëllezërve, ka reaguar në "Twitter" ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, i cili ka theksuar se ky është një tjetër hap drejt një Shkodre të qetë. "Zbardhja e vrasjes së dyfishtë të datës 30 mars në Shkodër është një tjetër hap drejt një Shkodre të sigurt, të qetë dhe të hijshme. Përgëzime për policinë dhe prokurorinë", shkruan Lleshaj.

AKUZAT NDAJ 2 TË ARRESTUARVE

Arsen Stojku, 29 vjeç, lindur dhe banues në fshatin Mjedë dhe Myslym Rama, 23 vjeç, po nga fshati Mjedë, akuzohen për të njëjtat vepra penale "Vrasja me paramendim kryer në bashkëpunim" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit". Ndonëse nuk është i përcaktuar qartë roli i tyre në krimin e rëndë të 30 marsit në Shkodër, policia tha se vrasësi i dy vëllezërve është Ibrahim Lici, i cili është shpallur në kërkim bashkë me një tjetër person me inicialet D.B., që dyshohet se e ka ndihmuar.

SHKODËR - Ibrahim Lici është shpallur në kërkim nga policia si ekzekutori i vëllezërve Bilali, ngjarje e ndodhur më 30 mars të këtij viti në Shkodër. Por, ky ishte akti i fundit i sagës së hakmarrjeve dhe përplasjeve mes grupeve kriminale në Shkodër. Burime për "GSH" bëjnë me dije se 26-vjeçari Ibrahim Lici, i dyshuari kryesor i vrasjes së dy vëllezërve Bilali është nip i Fatbardh Licit, i vrarë më 8 gusht 2018 dhe djali i Mustafë Licit, anëtar i Këshillit Bashkiak në Shkodër dhe drejtues i partisë "Mendimi i Djathtë Liberal". Nga ana tjetër, viktima Fatbardh Lici është kunati i Luzlim Kullës, biznesmenit të njohur ndaj të cilit u bë atentat më 13 janar të vitit të kaluar me lëndë shpërthyes ku mbeti i plagosur. Ky atentat dyshohet se ishte dhe ngjarja që prishi qetësinë mes grupeve në Shkodër. Në këtë atentat të kryer pranë tregut më popullor të qytetit mbetën të plagosur 8 persona, mes të cilëve edhe vetë Kulla. Ngjarjet sipas policisë lidhen me hakmarrjen dhe përplasjen mes grupeve kriminale si dhe aktivitetin e

Saga e hakmarrjeve në Shkodër, vrasësi i vëllezërve Bilali, djali i anëtarit të këshillit bashkiak



Viktima Fatbardh Lici

djalit të Astrit Bilalit, i cili mbeti i vrarë më 30 mars. Asmiri, një ish-kampion i sportit të boksit, i arrestuar në shtator të vitit të kaluar si pjesë e grupit kriminal "Bajri". Grupet kriminale që vepron në Shkodër kanë një histori më shumë se 25-vjeçare, mbushur me vrasje, kërcënime, trafik droge, prostitucion, rrëmbim të pronave etj. Gjatë viteve, disa prej grupeve u larguan nga skena pas vrasjes së drejtuesve të tyre. Mbijetuan grupet më të fu-

qishme, ato që ishin organizuar në bazë familjeje. **KRIMET NË SHKODËR** Atentati ndaj Luzlim Kullës u pasua nga atentate të njëpasnjëshme, ku deri tani kanë mbetur të vrarë 9 persona, ndërsa dy të tjerë figure urojnë të zhdukur.

13 janar 2018, atentat kundër biznesmenit Luzlim Kulla në afërsi të tregut popullor të qytetit të Shkodrës.

Qershor 2018, zhduken pa gjurmë Gëzim Hysa dhe nipi i tij, Agron Molla.

Në pranga ka rënë dhe Myslym Rama, 23 vjeç, lindur dhe banues në fshatin Mjedë, Bashkia Vau i Dejës, i dyshuar për veprat

18 qershor 2018, ekzekutohet me armë Mehdi Kavaja, pronar i një servisi.

15 korrik 2018, vriten në një atentat, në hyrje të banesës, ish-policë Boran Bercana dhe Silvi Ndoci, bashkëjetuese me të.

8 gusht 2018, vritet Fatbardh Lici, kunati i Luzlim Kullës dhe vëllai i Mustafë Licit. Ky i fundit këshilltar bashkiak dhe drejtues i një partie politike me shtrirje lokale.

1 shtator 2018, vritet biznesmeni Arjan Ferracaku teksa po kalëronte bashkë me Asmir Bilalin. Dyshohet se autorët e atentatit ngatërruan shënjestrën.

14 nëntor 2018, në tregun popullor të "Rusit" vritet Fatos Ferracaku, kushëri i Arjan Ferracakut.

20 mars 2019, në fshatin Grudë vritet Nard Polia, pronar i një bujtine në Theth, pjesëtar i administratës së Zonave të Mbrojtura.

30 mars 2019, vriten në derën e shtëpisë së tyre vëllezërit Bilali.

penale "Vrasja me paramendim kryer në bashkëpunim" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit". Ndërsa u

bë shpallja në kërkim e shtetasit Ibrahim Lici, 26 vjeç, si i dyshuari kryesor për veprën penale të vrasjes, si dhe e shtetasit D.B., 29 vjeç, për veprën penale "Përkrahja të autorit të krimin".

Policia vijon operacionin për gjetjen dhe kapjen e tyre. **HETIMI**

Pas hetimeve intensive të kryera në drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër rezultuan se shtetasit e lartpërmendur kanë planifikuar, organizuar dhe kryer në bashkëpunim këtë vrasje. Si rezultat i punës së vazhdueshme intensive me metodat speciale të hetimit nga grupi i posaçëm hetimor u bë sigurimi i provave materiale dhe shkencore, të cilat çuan në dokumentimin ligjor të kësaj ngjarjeje. Gjatë veprimeve hetimore u bë sekuestrimi i një automjeti, tre aparateve telefonike celulare, të cilët janë përdorur nga autorët gjatë kryerjes së veprimeve të tyre. Ndërsa vazhdon puna për hedhjen dritë mbi motivin e kësaj ngjarjeje dhe identifikimin e personave të tjerë të përfshirë. Materialet ndaj personave në fjalë i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për veprën penale "Vrasja me paramendim kryer në bashkëpunim" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe

Megagrabitja në aeroportin e Rinasit, arrestohet i 6-ti, "Daja" nga Kosova

Bashkëpunëtori i drejtësisë, Alkond Bengasi rrëfen takimin e fundit me Muratajn: Më thirri "o nip"

"U shoqërova pas vrasjes së avokatit Gurra, ja kush janë Olti e Tani nga Fushë-Kruja



TIRANË

Më shumë se tri javë pas megagrabitjes në aeroportin e Rinasit, gazetaria Klodiana Lala ka mundur të sigurojë ekskluzivisht për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" dëshminë e plotë të Alkond Bengasi, bashkëpunëtorit të drejtësisë i cili i rrëfeu Prokurorisë për Krime të Rënda gjithëcka dinte rreth ngjarjes së ndodhur më 11 maj dhe 9 prillit, ku brenda pistës së aeroportit, një grup i armatosur shpërtheu rrethimin dhe mori prej barkut të avionit afro 10 milionë euro. Bengasi, kushëri me Klement e Eldi Çalën, rrëfen detaje lidhur me anëtarët e grupit, takimet me Admir Muratajn, që e thërrasin "Daja", si dhe një kosovar rreth 50 vjeç, që gjithashtu kishte nofkën "Daja".

DËSHMIA E PLOTË E ALKOND BENGASIT

PËYETJE: Ndaj jush zhvillohen hetime, pasi dyshoheni për kryerjen e veprës penale të "vjedhjes me armë kryer në bashkëpunim". Kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal në lidhje me ngjarjen e ndodhur më 09.04.2019 në aeroportin e Rinasit, ku është grabitur me armë një shumë vlerash monetare (euro), pyetjen e dëgjuar, e kuptuat dhe çfarë shpjegimesh do të jepni?

PËRÇYQIM: U njohta me të drejtat dhe pyetjen e bërë në lidhje me ngjarjen e ndodhur më 09.04.2019, ku në aeroportin e Rinasit është grabitur një shumë vlerash monetare. Dua të deklaroj se unë jam dëgjues për këtë ngjarje, pasi unë njihem me shtetasin Klement Çala, i cili është kushëri i imi, pasi nënën e Klementit e kam gocë teze, ndërsa babain e Klementit, babai im e ka djalin dajë. Unë kam qenë në shtëpinë e Klementit, i cili në atë kohë jetonte me familjen e vet. Unë në vitet 2012-2013 saktësisht nuk më kujtohet jam kapur me një cigare hashash dhe kam qenë në burg në Shqipëri. Në atë kohë kur unë kam qenë në burg, kam marrë vesh me anë të televizorit se kushëri im, Klement Çala, është arratisur nga burgu "Triakalla i Greqisë" së bashku me disa persona të tjerë. Pasi unë kam dalë nga burgu pas 6 muajsh, Klementi kishte ardhur në Shqipëri dhe mbaj mend se ai ka ardhur dhe më ka takuar në shtëpinë time, në Elbasan dhe konkretisht në fshatin Kusarë. Në atë kohë Klementi së bashku me shtetasin Admir Muratajn po hapnin një restorant në zonë të Liqenit të Thatë dhe konkretisht në hyrje të digës së Liqenit. Pasi këtu dy shtetas kanë hapur restorantin, unë gjatë kësaj periudhe jam takuar disa herë me Klementin. Më pas mua më është sëmëruar nëna dhe Çjykata e Apelit më ka rikthyer në burg dhe jam shpallur në kërkim dhe për një periudhë unë takohesha shumë rrallë me Klementin.

Unë jam i punësuar në varrezën e makinave, të cilën e ka babai i Klementit, Pullumbi, varrezë, e cila ndodhet midis fshatit Kusarë dhe Bradashesh, Elbasan. Vëllai i Klementit, Eldi Çala, ka një rrobaguesi në Uzinën 12 në Bradashesh. Përpara rreth 5 muajsh më ka thënë shtetasi Eldi Çala se do të shkonim të merrnim një furgon në dalje të Fushë-Krujës dhe unë i kam thënë se nuk vij, se kam vajzën sëmëruar dhe të gjente një person tjetër për të shkuar për ta marrë. Pas dy ditësh kur unë kam shkruar tek rrobaguesia e Eldit kam parë një furgon. Unë në oborrin mbapa rrobaguesisë ndodhej i parkuar një automjet me ngjyrë jeshile i markës "Chevrolet", me targa të huaja, të cilat s'më kujtohen. Mbjaj mend se me këtë automjet Eldi bënte xhiro disa herë brenda territorit të rrobaguesisë. Unë e kam pyetur Eldin se ku e kishte gjetur këtë automjet dhe ai më është përgjigjur se këtë automjet e kishte sjellë nga lart (dhe unë nënkuptova shtetin e Kosovës) Admir Murataj, të cilin Eldi e thërriste me pseudonimin "Daja". Unë e kam pyetur sërish Eldin për ç'ka e do këtë automjet, pasi ishte i vjetër dhe ai më ka thënë se do e mbajmë për qejf, pasi është 4x4. Pas rreth 2-3 muajsh, Eldi e ka sjellë pikërisht automjetin që mërmend më lart në servisim (varrezën) ku unë punoj. Ai e ka lënë këtë automjet të parkuar rreth 3 javë ose një muaj në servisim tonë, me arsytimin se do ta rregullonte dhe do ta bënte makinë sportive këtë automjet. Në këtë automjet kam hyrë unë së bashku me shtetasin M.Çala, i cili është djali i xhaxhit të Klementit si dhe punonjësi në këtë varrezë (servis). Pasi Klementi si dhe lënë këtë automjet rreth tri javë ose një muaj në servisim ku unë punoj, një ditë që unë nuk ndodhesha në shtëpi dhe nuk kisha shkuar në punë. Eldi kishte shkuar në servisim ku unë punoj dhe e kishte marrë automjetin tip "Chevrolet" me anë të një karrotraci. Unë këtë fakt e mësova nga E.Çala dhe ai më ka thënë se automjetin e mori Eldi së bashku me shtetasin Talo Çela, i cili është nga Bradashesh. Pas rreth 3-4 ditësh, pikërisht automjetin tip "Chevrolet" e ka sjellë përsëri në servisim ku unë punoj shtetasi Eldi Çala, por kësaj here në gjendje të ndezur, pra këtë automjet e kishte rregulluar. Pas rreth 3-4 ditësh ka ardhur sërish dhe e ka marrë këtë automjet Eldi dhe në servis i kemi vendos vetëm bateri. Po kështu, unë në obor-



Grabitja në Rinas

rin e rrobaguesisë së Eldit përpara rreth një muaji kam parë të parkuar një automjet tip "Mercedes Vito" me ngjyrë të bardhë. Unë këtë automjet e kam parë vetëm njëherë dhe nuk e kam parë më. Unë automjetin tip "Chevrolet" që mërmenda më lart e kam parë në Rinas në 09.04.2019 në televizion gjatë emisioneve që jepeshin në lidhje me ngjarjen e grabitjes në Rinas. Këtë automjet e kam njohur nga mbirapakolpi, si dhe nga fotot që transmetoheshin në media, si dhe nga fakti që tregohet se automjeti ishte "Chevrolet" dhe ishte modifikuar stema e "Volvsagen"-it si dhe modifikime të tjera.

Përpara disa kohësh mesa më kujtohet, disa ditë pasi është vrarë avokati Ravik Gurra në qytetin e Elbasanit, unë së bashku me babain e Klementit, Pullumb Çala si dhe një kushëri i tim na ka shoqëruar policia në drejtorinë e Elbasanit, ku jemi pyetur në lidhje me ngjarjen e vrasjes së avokatit. Atë ditë pasi kemi dalë nga policia e Elbasanit, unë kam ardhur në shtëpinë time të Liqenit i Thatë, në Tiranë dhe në banesën time po atë ditë në darkë ka ardhur Klementi së bashku me nusen e tij dhe fëmijët dhe gjatë bisedës ai më ka treguar se "ç'ka policia me ty, shih mos të kanë vendos ndonjë përgjues në makinë". Po këtë natë kur Klementi ka qenë në shtëpinë time, ai më ka thënë se "do të dëgjosh një tronditje të madhe këtu ditë". Pasi unë pashe fotot e automjetit që kishte marrë pjesë në grabitjen e Rinasit si dhe në lidhje me bisedën që Klementi me kishte thënë natën që ishte në shtëpinë time se "do të dëgjosh një tronditje të madhe këtu ditë", unë nënkuptova se në këtë grabitje kishte marrë pjesë patjetër Klementi së bashku me Admir Muratajn, që e kishte shok të ngushtë. Menjëherë sa kam mësur në lidhje me ngjarjen e ndodhur, kam fikur telefonin pasi kisha frikë. Dua të shpjegoj se Klement Çala kishte një banesë afër shtëpisë sime të Liqenit i Thatë, si dhe Klementi më ka thënë se edhe "Daja" që nënkuptonte Admir Muratajn, e ka shtëpinë përballë pallatit tim, në anën tjetër të Liqenit të Thatë.

Unë shkoja shpesh në banesën e Klementit, e cila ndodhej afër shtëpisë sime dhe në këtë banesë vinte shpesh edhe Admir Murataj. Po ashtu e kam takuar Admirin edhe me një person tjetër nga Kosova i moshës rreth 50 vjeç, qeros, të cilin Admiri e thërriste me pseudonimin "Daja". Unë këtë person jam në gjendje që ta identifikoj nëse ai më tregohet. Po me këtë shtetas vinin edhe dy persona të tjerë, të cilët ishin nga Fushë-Kruja, me sa di unë ku njëri tjetër me emrin "Olti" dhe tjetri "Tani". Ata të dy vinin me një makinë "Golf" ngjyrë blu dhe të dy këta persona takoheshin me Admir Muratajn dhe shtetasin kosovar, të cilin Admiri e thërriste "Daja". Herën e fundit që unë e kam takuar Admir Muratajn në momentin që po zbrisja për të blerë cigare të dyqani që ndodhet afër pallatit, dyqani i cili ndodhet në pallatin e Klementit, ka qenë rreth 6 ditë para se të ndodhte grabitja në Rinas. Një person më fishkëllëri, unë kthejë kopën dhe arrita të dalloj Admir Muratajn, i cili më thirri o nip dhe unë kam shkuar dhe jemi takuar dhe aty shikoi se në automjetin "Golf" ngjyrë të bardhë me targa kosovare ndodhej edhe "Daja" nga Kosova, i moshës rreth 50 vjeç, qeros. Pasi Admiri më ka dhënë dorën dhe më ka përshëndetur, ai ka hyrë në shkallën e pallatit ku banon Klementi dhe është ngjitur lart. Unë sa herë e kam parë shtetasin kosovar, e kam parë që ai ishte në shoqërinë e Admir Muratajt. Po kështu, dua të shpjegoj se unë Oltin dhe Tanin, të cilët di

që janë nga Fushë-Kruja, i kam takuar për herë të parë përpara 6 muajsh të "Shkëmbi i Kavajës", afër pallatit të lartë. Jemi nisur unë dhe Eldi nga Elbasani dhe në një lokal të "Shkëmbi i Kavajës", kemi ngrënë drekë së bashku me Admir Muratajn, personin të cilin Admiri e thërriste "Daja" dhe ishte nga Kosova. Oltin dhe Tanin nga Fushë-Kruja, Klementin si dhe një person tjetër, të cilin e kishte shok "Daja" nga Kosova dhe që ishte i shëndoshë. Përpara 10-15 ditësh, rreth orës 08:30 të mëngjesit kur unë kam qenë duke shkuar për në Elbasan, kam parë në kafen që ndodhet disa metra larg pallatit, në afërsi të një hoteli që po ndërtohet, Admir Muratajn, shtetasin kosovar që thirrej "Daja", Oltin, Tanin, Klementin dhe Eldin. Kur kam vazhduar rrugën me makinë rreth 20 metra larg kafes ku po pinin shtetasit e mësipërm, kam parë që vjen me automjetin e tij, Talo Çela. Nuk jam në gjendje të them ditën e saktë, por unë një ditë në momentin që kam dalë nga banesa ime për të hedhur mbeturinat kam takuar Klementin, të cilin e kam pyetur se ku po shkante dhe me ka thënë se do shkoj të takoj Admirin me çunat. Po kështu tek banaea e Klementit, e cila është afër shtëpisë sime, shpeshherë kam parë se Eldi Çala vinte dhe hynte në banesën e Klementit me kushëririn Renaldo Sula. Dua të shpjegoj se kur unë kam shkuar në shtëpi, kam parë nusen time të shtëpisë dhe, e cila më ka treguar se shife çfarë ka ndodh dhe aty kam parë në lajme se ç'ka kishte ndodhur, kur ishte vrarë edhe një grabitës. Menjëherë kam shkuar në banesën e Klementit dhe aty kam gjetur duke qarë nusen e Klementit, e cila quhet Sulltana së bashku me nusen e Eldit, e cila quhet Ana. I kam pyetur përse qanë dhe përse jeni të shtëtuara dhe ato më kanë thënë se kanë vrarë Klementin në Rinas, sipas të dhënave në media, pasi Klementi ishte rreth 32 vjeç. U mundova të kërkoja, por ato vazhdonin të ishin të shtëtuara dhe këmbëngulim që ishte Klementi, por nuk ishin të sigurt se gjatësia e personi nuk përputhej. Unë kam qëndruar rreth 30 minuta në shtëpinë e Klementit dhe duke qenë se nusja e tij dhe Eldit po qanin dhe ishin mjaft të shtëtuara, kam shkuar në banesën time dhe kam dalë në ballkon, ku po pija cigare. Aty kam vënë re se dy gratë dolën nga banesa dhe më thanë që po ikin se më duket është vrarë "Daja", që nënkuptonte shtetasin Admir Murataj, pasi sic e mërmenda edhe më lart të gjithë Admirin e thërrisnin "Daja". Po kështu, dua të shpjegoj se disa herë në banesën e Klementit vinte edhe bashkëshortja e Admirit, e cila quhet Albana dhe ajo vinte me dy vajzat. Unë e kam parë Albanën të hynte në banesën e Klementit së bashku me Admir Muratajn.

PËYETJE: A mund të na shpjegojë nëse jeni të gjendje të identifikoni shtetasit me emrat Tani dhe Olti, që ju deklaruar se janë nga Fushë-Kruja, nëse ata ju paraqiten për njohje nga ana jonë?

PËRÇYQIM: Po unë jam në gjendje t'i identifikoj këta persona, nëse më paraqiten nga ana juaj. Olti është i moshës rreth 40 vjeç, me trup rreth 175 cm i gjatë, trup normal, me flokë si të verdhë, me fytyrë të bardhë, me dialekt si nga Fushë-Kruja. Olti mësa më ka thënë Klementi ka qenë në forcat komando, që kanë qenë jashtë shtetit. Tani është i moshës rreth 35 vjeç, me trup rreth 180-185 cm, trup normal pa bark, me flokë gështenjë të shkurtra, ai vishet zakonisht sportiv. Sa herë e kam parë, mbante të njëjtat veshje. Të dy këta shtetas qëndronin të parruar, por jo më mjekër të madhe, për të dy këta shtetas kam dëgjuar se ishin besimtarë të fesë myslimane. Kujtoj që Tanin e kam parë njëherë në Elbasan së bashku me Eldin të rrobaguesisë. Kujtoj që ka qenë aksham dhe më ka marrë e ëma e Klementit e kam shkuar t'u jap ushqim qenve.

PËYETJE: A e njihni shtetasin Saimir Çela, nëse po çfarë marrëdhënie jeni me këtë shtetas?

PËRÇYQIM: Po unë e njoh këtë shtetas është nga qyteti i Elbasanit, dhe e thërrasin me pseudonimin "Taça", por unë nuk kam muhabet me këtë shtetas. Di që banon afër banesës së Renaldo Sulës, që është çuni i dajës së Klement Çalës dhe di që merret me grumbullim dhe luleve të egra.

PËYETJE: Kemi dëgjuar se në çfarë qyteti banonte "Daja", shtetasi kosovar në Kosovë?

PËRÇYQIM: Unë nuk kam informacion të saktë, por kam dëgjuar që Admiri qëndronte në Kosovë, në Prishtinë. Kujtoj që Daja, Admir Murataj dhe Klement Çala mbanin gjithnjë armë me vetë. Admiri mbante dy pistoleta dhe bomba në cantë. I kam parë kur më ka kërkuar t'i marr njëherë cigaret në cantë. Ndërsa Klementi mbante një armë tip "Glock", që ia kishte blerë "Dajës" nga Kosova dhe ka thënë që e ka blerë për 2500 euro.

PËYETJE: A kemi një tjetër për të shtuar në deklaramin tuaj?

PËRÇYQIM: Jo, nuk kam gjë tjetër për të deklaruar, procesverbalin e deklaramit pasi e lexoj, e gjej të rregullt dhe e firmos pa vërejtje të tilla.

Ndërtimet pa leje, marrin tapitë për truallin 1000 përfitues, sipërfaqet që legalizohen

Qeveria miraton një fond prej 105 milionë lekësh për kompensimin e 300 pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Në të njëjtin vendim është miratuar edhe kalimi i pronësisë për truallin mbi të cilin është ndërtuar. "Masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara, referuar kartelave të pasurive sipas Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme është 10 993,97 m² dhe vlera totale e kompensimit financiar është 105 224 873 lekë", - thuhet në vendim. Gjithashtu, është miratuar kalimi i së drejtës së pronësisë, në favor të subjekteve përfituese për 633 prona me rreth 1000 pronarë. Vlera e kompensimit financiar për pa-

Agjencia e Kadastrës, 105 milionë lekë për 300 pronarë

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Shkodër

suritë vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, e cila bën të ditur listën me përfituesit.

TAPITË

Këshilli i Ministrave miratoi të mërkurën edhe kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të

legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre. Sipas vendimit të qeverisë, mësohet se për qarkun Elbasan (ZVRPP Elbasan, Peqin, Librazhd) janë pajisur me tapi 163 persona, për

qarkun Durrës (ZVRPP Durrës) 24, për qarkun Tiranë (ZVRPP Tiranë dhe Kavajë) 174, për qarkun Fier (ZVRPP Lushnjë) 20, për Shkodrën 9, për qarkun Vlorë (ZVRPP Vlorë dhe Sarandë) 186, për qarkun Gjirokastër 45, për qarkun Lezhë 9, për qarkun

Kukës dhe për qarkun Korçë nga një. Këshilli i Ministrave urdhëron Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, Elbasan, Librazhd, Durrës, Tiranë, Lushnjë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, Kavajë dhe

Kukës të regjistrojnë brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi kalimin e së drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekën ligjore mbi to. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Kompensimi i Pronarëve				
Emër	Atësi	Mbiemër	Shuma - Vlera e	
BELUL	XHAFER	KANAÇI	50,376.25	
REFUE	XHAFER	KALIVÇI		
DILE	XHAFER	LUZI		
KUSHE	XHAFER	SULKA		
XHEZMIE	XHAFER	DUZHA		
SOSE	XHAFER	KALVAÇI		
FATMIR	XHAFER	PASHAJ		
GJYLSYME	RRAHMI	BASHA	5,738,694.40	
DALIP	KADRI	BAKALLI	219,540.80	
FATUSH		BAKALLI		
NASHIFER		BAKALLI		
MELEQ		BAKALLI		
KADESHE		BAKALLI		
MUSA		BAKALLI		
SHEJNAZ		BAKALLI		
BURBUQE		BAKALLI		
DRITAN	SADIK	CENGELI		
AHMET	RAMAZAN	BYLYKBASHI		4,809,475.20
GAZMENT	FAIK	HAXHIYMERI		39,568.40
KASTRIOT	HYSNI	ZABELI		4,073,834.6
BUJAR	HYSNI	ZABELI		
EGLANTINA	HYSNI	ZABELI		
SHPRESA	HYSNI	ZABELI		
ARJANA	HYSNI	ZABELI		
PLATON	HYSNI	ZABELI		
ELIDA	HYSNI	ZABELI		
FERDINANT	SULEJMAN	MURATI		
HATXHE	SULEJMAN	KAFEXHIU		
VIOLLCA	SULEJMAN	DHEFTO		
SHPETIM	NAZMI	SKILJA		
TOMORR	YMER	SAMARXHIU		
AVNI	YMER	SAMARXHIU		
LEDIO	KASTRIOT	ZABELI		
LMA	KASTRIOT	ZABELI		
ABAZ	FETAH	LAMA	1352800	
TOMORR	XHEMAL	LUGA	924888	
OSMAN	ALI	HASRAMA	456960	
NAZMI	VATH	MISIRI	539748	
NDUE	LAZER	PJETRA	377,888.4	
MALIQ	IDRIZ	IDRIZI	122250	
XHEVDET	MALIQ	IDRIZI		
LUMTURI		TORO	76,435.20	
ILDIKA		FORTUZI		
NERMIN		CANGU		
GLEDION		FORTUZI		
AGRON		SKENDERI		
BASHKIM		KACA		
EDMOND		MEMA		

JALLDIZ		MEMA	946,853.10	
LULZIM		KACA		
ROLAND		MEMA		
YLLI		MEMA		
RITA		MEMA		
ILIR	BAJRAM	PIRI	2,390,793.30	
SADIK	QAZIM	PIRI		
MERSIN	QAZIM	PIRI		
LEJLA	BILAL	VOGLI		
DHURATA	BILAL	VOGLI		
IRFAN	BILAL	VOGLI	411,859.35	
SUZANA	BILAL	VOGLI		
JETA	BILAL	VOGLI		
EDA	BILAL	VOGLI		
MARIGLENA		RAPUSHI		
NAXHUE		RAPUSHI	76,344.66	
ADRIAN		RAPUSHI		
DHURATA		KADELUP		
MAGDA		IKONOMI		
ALFRED		BENUSI		
ADILE	BESIM	TAKO	198,564.50	
FATBARDHA	IBRAHIM	DRAGONI		
LILJANA	BESIM	RADHESHI		
LULJETA	IBRAHIM	DRAGONI		
TEFTA	BESIM	SPAHIU		
URAN	IBRAHIM	DRAGONI		
ALBINA	SABRI	SHASHAJ		612,462.60
GENC	HAMDI	SULCEBE		
MIRGJIND	SABRI	TEFIKU		
BLERINA	SABRI	SELENICA		
ELVI	RAMAZAN	KADIU		
GENARD	RAMAZAN	KADIU		
BAFTISHA		KADIU		
BRIZIDA		BROJKA		
MIRVJEN		KADIU		
KUTJIM		SHEMLLIU		
GENC		SHEMLLIU		
HIQMET		KADIU		
BASHKIM		KALAJA		
ARDIAN	NEXHMI	KADIU		
SEMIHA	ZYHDI	MULLAJONUZI		
LIRI	ZYHDI	GJEVORI		
ALMA	DALIP	DEDE		
LIRUE	ABDURAHMAN	ARAPI		
BRIKENA	ILMI	DEMNERI		
DIANA	MUHAMET	LASKU		
AGRON	RAMAZAN	FORTUZI		

ALTIN	ILMI	KADIU	434,340.30	
HATXHE	MUHMED	KALLESHI		
MIRANDA	REXHEP	KADIU		
ALI	ZYHDI	IBERSHIMI		
ARBEN	ZYHDI	IBERSHIMI	2267824	
DORINA	AGRON	FORTUZI		
FATBARDHA	ZYHDI	IBERSHIMI		
JETA	ZYHDI	IBERSHIMI		
MEDHA	NEXHMI	KADIU		
SHPRESA	ZYHDI	IBERSHIMI		
SAIMIR	MYNIR	KADIU		
LINDITA	MYNIR	DERVISHI		
FATO		ALIAJ		
FJONA		DOLLANI		
MAKSIM		GEGA		
MIRJETA		XHELAI		
PERPARIM		GEGA		
SILVANA		ALIKE		
ZAMIRA		VELO		
FATO		ALIAJ	1995249	
FJONA		DOLLANI		
MAKSIM		GEGA		
MIRJETA		XHELAI		
PERPARIM		GEGA		
SILVANA		ALIKE		
ZAMIRA		VELO		
GEZIM		BRAHIMI		2405201.8
YLLKA		BRAHIMI		
NEXHAT		HOXHA		630,120.00
EVALD		HOXHA		
JONIK		HOXHA		
HILMI	RESUL	SHEQIRI	198375	
MARK	LAZER	GJERGJI	114000	
BARDHUL	FATMIR	HAXHIHYSENI	3,894,296.4	
BALLKYZ	ISMAIL	HAXHIHYSENI		
FLORESHA	ISMAIL	HAXHIHYSENI		
ARBEN	FATMIR	HAXHIHYSENI		
ALI	HYSN	KOPILI	1,689,953.60	
BIHANE	IDRIZ	ZYMA		
LUMNI	HYSN	VERO(KOPILI)		
SUZANA	HYSN	XHEPA(KOPILI)		
GEZIM	KAMER	MERKO		1,955,444.80
DEMIR	REXHEP	KRASNIQI	334,416.80	
NDUE	MAN	PEPKOLAJ	76,435.20	
ALFRED	LYTFI	HOXHA	339075	
ALIDE		JARECI		
BARDHYLE		DIBRA		
ELONA		JARECI		

IKBALE		XHURETA	
ILVA		BYTYCI	
ILVIE		IZETI	
INA		JARECI	
JAZEFILDA		JARECI	
NAMIK		JARECI	734,768.00
ALIDE		JARECI	
BARDHYLE		DIBRA	
ELONA		JARECI	
IKBALE		XHURETA	
ILVA		BYTYCI	
ILVIE		IZETI	
INA		JARECI	
JAZEFILDA		JARECI	
NAMIK		JARECI	676,760.00
ALIDE		JARECI	
BARDHYLE		DIBRA	
ELONA		JARECI	
IKBALE		XHURETA	
ILVA		BYTYCI	
ILVIE		IZETI	
INA		JARECI	
JAZEFILDA		JARECI	
NAMIK		JARECI	6,593,576.00
ALIDE		JARECI	
BARDHYLE		DIBRA	
ELONA		JARECI	
IKBALE		XHURETA	
ILVA		BYTYCI	
ILVIE		IZETI	
INA		JARECI	
JAZEFILDA		JARECI	
NAMIK		JARECI	2,262,312.00
TOM		VATAJ	7,076,976.00
ATNAN		JARECI	
BARDHYLE		DIBRA	
IKBALE		XHURETA	
ILVA		BYTYCI	
ILVIE		IZETI	
INA		JARECI	
JAZEFILDA		JARECI	
NAMIK		JARECI	2,707,040.00
ATNAN		JARECI	
BARDHYLE		DIBRA	
IKBALE		XHURETA	
ILVA		BYTYCI	
ILVIE		IZETI	
INA		JARECI	
JAZEFILDA		JARECI	
NAMIK		JARECI	696,096.00
ATNAN		JARECI	
BARDHYLE		DIBRA	
IKBALE		XHURETA	
ILVA		BYTYCI	
ILVIE		IZETI	
INA		JARECI	
JAZEFILDA		JARECI	
NAMIK		JARECI	4,331,264.00
ATNAN		JARECI	
BARDHYLE		DIBRA	
IKBALE		XHURETA	
ILVA		BYTYCI	
ILVIE		IZETI	
INA		JARECI	
JAZEFILDA		JARECI	
NAMIK		JARECI	5,317,400.00
MAKSIM		GEGA	
PERPARIM		GEGA	
FATO		MASKAJ	
MIRJETA	ALIM	XHELAI	

MIRJETA	ALIM	XHELAI	
FJONA	FATOS	DOLLANI	
SILVANA	ALIM	ALIKE	
ZAMIRA		VELO	5,451,500
Të dhënat e Pasurisë			Sipërfaqja për kalim pronësie (m ²)
Emër	Atësi	Mbiemër	
GËZIM	IBRAHIM	ÇOLLAKU	218.4
HYSNI	HAZIZ	KOLONJARI	231.2
KLODIAN	LIO	ZGURI	376.8
MUSTAFA	IDRIZ	BEQIRI	82.9
DHIMTËR	MEHMET	GJOKA	131.9
AFROVITI	ISMAIL	GJOKA	
FUAT	MEHMET	MYZYRI	24.0
GAZMEND	VATH	HIDA	102.3
FATMIR	ISA	BICI	300.0
FREDI	JASHAR	MUSKA	78.4
MUSTAFA	ALI	DUKA	184.1
QAZIM	KADRI	SERICA	28.5
ZAMIRA	SULEJMAN	DEBROVA	90.0
ABDYRRAHIM	HASAN	EKMEKÇIU	198.1
BESA	DEMIR	SHINGJERG	11.4
ISUF	KAMER	DUHANXHI	92.4
KADRI	SELIM	POKA	
XHEVDËT	RIFAT	HAKA	
7	ABEDIN	BEGOLLARI	
DHESPINA	RRAPI	BEGOLLARI	
TRITAN	PASHO	KULLOLLI	
ARDIAN	MUSA	LLAPUSHI	
SADUE	ADEM	LLAPUSHI	
FITNET	XHAFERR	KOFSHA	13.7
YMER	SELIM	RUÇI	266.3
MAKSIM	ZALO	REXHEPI	386.7
NADIRE	ISMAIL	KASA	194.1
PËLLUMB	KOSTANDI	URUÇI	432.0
HASAN	SHEFQET	SINANI	347.4
VIKTOR	AVNI	SINANI	336.9
AVNI	MAKSUT	SINANI	
KADRI	SEFER	ELEZI	351.1
HAXHI	TAFIL	NEXHA	333.9
HASAN	LATIF	ÇULLHAJ	369.6
FATMIRE	RAMAZAN	FERHATI	296.1
TAHIR	QAZIM	DUBALI	341.4
SHEFQET	ZYBER	RRANÇI	392.0
MAKO	RRAPUSH	JAKUPI	200.0
ARDIAN	VANGJEL	DAKA	477.6
HAZIZ	XHELAL	DELIU	349.8
HEKURAN	FERDINAND	ÇELHEMA	318.0
LIRI	FADIL	BAHA	399.3
QERIM	SELIM	GJEVORI	300.0
ARBEN	MUSA	XIBRAKU	309.6
MUSA	OSMAN	HASANI	98.5

ALBAN	RUZHDI	KALIA	247.8
NAILE	QEMAL	META	242.8
MEVLUT	XHEMAL	META	
NDRÇIM	HALIT	SHULI	310.5
YLLI	MEHMET	BEKTASHI	670.2
ALI	TAHIR	SINANAJ	299.8
ADEM	ALI	ZEJNELI	499.2
XHAVAHIR	JASHAR	FAQOLLI	235.8
ORGEN	ZENEL	BARDHI	361.2
DAUT	QAZIM	HASANI	306.0
FESTIM	OSMAN	BASHA	221.1
ARBEN	FERIT	BOÇI	247.8
QEMAL	AQIF	KRYEMADH	317.1
HYSNI	DEMIR	TAFA	484.8
ARBEN	ABAZ	MURATI	303.3
NDRÇIM	REXHEP	SHPATARA	225.3
PULLUMB	HALIL	ÇERRI	143.4
SOPOT	HALIL	ÇERRI	
HEKTOR	JANI	DYRMA	500.0
SKËNDER	MUSTAFA	SALLA	427.5
BLERTA	SHYQYRI	SALLA	
BESNIK	SHABAN	GJINI	298.2
BLENDAR	AGIM	KOÇI	110.1
FLORESHA	SHAHIN	KOÇI	357.9
BLENDAR	AGIM	KOÇI	
AGIM	ABEDIN	SOLLAKU	410.1
SEFEDIN	SHERIF	GRECA	67.5
ARBEN	MEHMET	GAJDA	91.9
VALTER	ZEQIR	HOXHA	95.3
ARJAN	GORI	PETOVA	150.0
SKENDER	RRAPUSH	PARALLOJ	260.0
ERALDA	SABRI	DACI	81.6
HABIBE	BAJRAM	DACI	434.1
HALIT	HASAN	GJINI	145.1
SANJË	SABRI	GRYKSHI	93.5
NIKOLLA	PETRAQ	GJOKA	172.7
VALENTINA	OSMAN	GJOKA	138.5
ERVIN	THASAN	GJOKA	
TOMORR	HALIT	DEBROVA	
ALEKS	KOL	QOSJA	
BARDHUL	SHEFQET	CANI	124.0
AGRON	QAZIM	FILJA	274.4
QEMAL	RAMAZAN	TUSHA	192.5
MEREME	SELIM	TUSHA	
BESIM	SALI	FIRAKU	239.6
SHEFIKAT	XHEMAL	FIRAKU	
HATIXHE	RIZA	STAFI	
NERTILA	IBRAHIM	STAFI	
LEDJAN	IBRAHIM	STAFI	
SIDORELA	IBRAHIM	STAFI	35.0
FILIP	PALI	BERDUFI	156.7
DILAVER	HAQIF	GJOKOLA	113.4
NDRÇIM	MUHAME	HYSA	40.5

(vijon)

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Perbarimore L.D.C

- Nr. pasurisë 50/1, ZK Virua, vol 1, fq 27, Trulli me sip. 240.47 m² + ndertese me sip. 240.47 m². Regjistruar ne ZVRRP Gjrokaster ne emer te Fatos Cela. Çmimi fillestar per shitje eshte 3.445.600 Leke.

- Nr. pasurisë 190/84, ZK 2647, vol 2, fq 247, Trulli me sip. 300 m² + ndertese nje kateshe me sip. 88 m². Regjistruar ne ZVRRP Tepelene ne emer te Votim Çela. Çmimi fillestar per shitje eshte 1.064.000 Leke.

Data e shpalljes 09.04.2019
Data e zhvillimit 08.05.2019 deri ne oren 16.00
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Shitje me Ankand të Dytë nga Studio Perbarimore L.D.C

"Trulli" me sip. 1,874m² nga e cila 250 m² eshte ndertese, me Nr. Pasurisë 134/33, vol. 25, faqe 82, ZK 2436 e ndodhur ne Levan, Fier. Regjistruar ne Z. R. P. P. Fier ne emer te Shoq. Albjon shpk. Çmimi fillestar per shitje eshte 6.180.854 Leke.

Data e shpalljes 02.04.2019
Data e zhvillimit 07.05.2019 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
Rr. "Flish Dala", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tirane
Web: www.3h.sh; Email: shqgj_3h@yahoo.com; cel:0692039711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.23.04.2019 deri ne dt. 02.05.2019 per: sendin e luajtshem- gjysem rimorejko, marka Shmitz, Spr me Targa AER 936, me cmim fillestar 199,824.00 Leke automjetin gjysem rimorejko marka general trailers, F34 me Targa AER 360 me cmim fillestar 169,850.00 Leke ne pronesi te Subjektit Klodian Xhani PF me NIPT L02025004L.
Ankandi zhvillohet ne zyren perbarimore ne daten 02.05.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

"EPIRI I VERIUT" DOSSIER

Zyrtarizimi i platformës shovene helene "Megali Idea"

Si u krijua më 1914 qeveria e përkohshme vorioepirote

Zografi kërkoi që edhe Lunxhëria të shpallej zonë pakice greke

Nga Dr. Hasan Luçi

(vijon nga numri i djeshëm)

Pushtimi nazifashist i Greqisë në 1941 uli deri në tapitje veprimtarinë greke antishqiptare se Greqia kapitulloi shpejt.

Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, diktatorët monarkofashistë grekë që hipën në pushtet, me ndihmën e anglo-amerikanëve, rifilluan me zell e ashpërsi veprimtarinë e lëvizjes "vorioepirote". Për këto qëllime, qarqet greke u përpogën për të krijuar një bazë juridike të re për mëtimet e tyre, duke shpallur tezën absurde se gjoja Shqipëria ka marrë pjesë si agresore në luftën e Italisë kundër Greqisë, përkrah fuqive të boshtit fashist dhe mbi këtë mashtrim të pastër, pasi Shqipëria ishte e pushtuar nga Italia e jo shtet sovran, Greqia e quajti veten me të drejtën ligjore të gjendjes së "luftës" me Shqipërinë. Sipas qeverisë greke kjo gjendje lufte e Shqipërisë do t'i jepte fund vetëm pasi Shqipëria të njihje mëtimet territoriale greke dhe t'i kthehej Greqisë "Vorio Epiri". Ky ligj absurd mbahet ende sot nga Greqia, e cila sa për sy e faqe ka thënë se e paska hequr, një gënjeshtër me bishta. Mbi këtë bazë "juridike" u zbatuan planet e reja të provokacioneve, diversionit e propagandës, përfshi agresionin e armatosur në gusht 1949 për të realizuar mëtimet e vjetra shovene me mbështetjen e fuqive të mëdha të Luftës së Ftohtë për të përmbysur pushtetin popullor në Shqipëri, të planëzuar qysh kur u bindën se PKSH, me Luftën Nacionalçlirimtare,



sigurori lirinë e pavarësinë e vendit, si anëtarë e plotë e aleancës antifashiste botërore fitimtare. Kështu Greqia mori pjesë në tërë komplotet për rrëzimin e pushtetit popullor me aleatët perëndimorë e lindorë në pas, duke përdorur provokacionet kufitare, propagandën, diversionin dhe rrjetet agjenturore brenda e jashtë Shqipërisë.

Pasi dështoi ky komplot perëndimor sidomos në 1950-1953, në vitet 1960 u vu në zbatim komploti i T.Sekjos me Flotën e 6 të ShBA e Anglisë. Por ky komplot u organizua me qëllim që të mos komprometohet qeveria greke, duke ngarkuar zbulimin grek "QIPI", i cili më 1952 në Janinë krijoi organizatën terroriste diversioniste "Destle", e cila si qendër e rëndësishme e zbulimit grek e CIA, organizoi, drejtoi e zhvilloi një veprimtari të egër politike, diversive e agjenturore kundër RPSH dhe luajti rol me rëndësi me përgatitjet e këtij komploti. Demaskimi i bërë nga PPSH i këtij komploti bëri që të binte disi përkohësisht veprimtaria e zbulimit grek dhe e lëvizjes "vorioepirote" në atë kohë.

Tradhtia e hrushovianëve

ndaj PPSH e RPSH ringriti veprimtarinë armiqësore kundër vendit tonë nga të gjithë fqinjët në bashkëpunim me Perëndimin e Lindjen. Vizita e deklarata armiqësore e Hrushovit para nipit të Venizellosit, Sofokliut, duke i quajtur të drejta mëtimet shovene greke ndaj trojeve shqiptare, i dhanë hov zjarrit të veprimtarisë së lëvizjes "vorioepirote", hapur e fshehtas që vijoi deri në prill 1967 kur erdhën në fuqi pushtet ushtarakë, kolonelët grekë. Në Janinë në 1967 u bë kongresi panepirot me bujë të madhe demonstruese kundër Shqipërisë. Sipas dëshmitarëve të kohës, ushtria greke e divizionit të 8 u afrua në kufijtë shqiptarë. E.Hoxha urdhëroi gatishmërinë nr.1 luftarake të ushtrisë në tërë kufirin e vendit. Ministri i Mbrojtjes B.Balluku, me shtabin për rreth në kufi, urdhëroi: nëse ushtria greke kërkoi kufirin tonë, hapni zjarr me çdo mjet dhe sulmim e parë ndaleni në Janinë! Sa dëgjuan këtë urdhër të prerë, ushtria greke iku në panik 30 km larg kufirit tonë. Gjithashtu E.Hoxha mbajti fjalimin historik duke paralajmëruar qeverinë

greke se, nëse do të bënin ndonjë aventurë Athina nuk do të përjashtoj nga goditja shqiptare.

Me ardhjen në fuqi të Papadhoppullit dhe sidomos me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve më 1971, veprimtaria e

lëvizjes "vorioepirote" pësoi një farë rënie. Qeveria ushtarake greke, për arsye të gjendjes së brendshme e të jashtme, ndërpreu ndihmat financiare për këtë lëvizje dhe gati ndaloi përkrahjen e hapur të saj, duke ndaluar manifestimet, mitingjet e propagandën armiqësore të qarqeve zyrtare vorioepirote kundër Shqipërisë. Por qeveria greke nuk i ndaloi as i hodhi poshtë mëtimet ndaj Vorio Epirit sidomos ato të organizimave gjoja private të qarqeve shovene. Në fakt, pavarësisht nga masat frenuese që mori, herë pas here zyrtarë të lartë të qeverisë Papadhoppulos deklarorin se "Greqia nuk i tradhton për asnjë çast interesat e saja kombëtare", se "vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë nuk do të thotë aspak se Greqia nuk i ka parasysh të drejtat e saja të paparashkruara" etj. Me hipjen në fuqi të Karamanlisit më 1974 u nxit ringjallja e plotë e lëvizjes "vorioepirote" pasi ai njihje si personalitet shovene dhe antishqiptar i vjetër, megjithatë gruan e kishte arvanitase. Në mesazhin e përirimit të tij si kryeministër, rrethet "vorioepirote" i shprehën bindjen se do t'i përkrahte e mbështeste ata



hapur në veprimtarinë e mëtimeve antishqiptare. Këto rrethe nuk u gabuan se Karamanlisi u premtoi ndihmë e përkrahje pa rezervë qarqeve vorioepirote, me kusht që lëvizja e tyre t'i përshtatej brenda hullive të politikës së qeverisë greke që do të ndiqte ndaj Shqipërisë. Në fakt, koha tregoi se si qeveria e Karamanlisit dhe e Ralisit i kushtuan vëmendje të veçantë lëvizjes "vorioepirote", nuk i kursyen për asnjë çast ndihmat financiare, premtimet e përkrahjen sidomos me forma pune të fshehta në përputhje me koniukturat politike në Greqi e Ballkan dhe më gjerë si dhe në marrëdhëniet Greqi-Shqipëri. Në kohën e Ralisit, pas ngjarjeve të popullit në Kosovë për liri e pavarësi, u rrit edhe më veprimtaria e lëvizjes "vorioepirote". Me hipjen në pushtet të Andrea Papandreut në 1981, rrethet "vorioepirote" e shtuan së tepërmi veprimtarinë e tyre armiqësore kundër RPSH. Kjo nxitje zjarri u bë edhe si presion ndaj Papandreut, të cilit nuk ia dinin qartazi qëndrimet e tij për problemin vorioepirot për të mos bërë lëshime. Në fakt qeveria e Papandreut nuk e pengoi veprimtarinë e rretheve "vorioepirote" por u përpogë ta kontrollonte e ta kanalizonte në përshtatje me interesat politike të kohës që ajo ndiqte ndaj Shqipërisë. Për këtë qëllim ajo bëri përpjekje e vendosi në krye të disa sillojeve, me

veprimtari të theksuar antishqiptare, anëtarë apo simpatizantë të partisë së PASOK-ut. Me hipjen e Ramiz Alisë në krye të partisë shtetit në 1985 nisi gjoja normalizimin e marrëdhënieve me lëshime të ndryshme, por Greqia veprimtari të shpejtë, që kulmoi gjatë tranzicionit shkaktërrues "demokrat". Prej kësaj kohe jeni vetë dëshmitarë, i madh e i vogël, se si u ngulën tentakulat shovene greko-mëdha në tërë vendin dhe Greqia sot na shantazhon me "fshestat" greke ndaj mërgimtarëve tanë në Greqi, të cilët janë të çmuar për ekonominë greke por Greqia po i përdor politikisht sa herë i intereson. Harroji Greqia se si shqiptarët trajtuan emigrantët e uritur grekë që erdhën në Shqipëri herë pas here, megjithatë ka shkruar edhe shtypi grek.

KRIJIMI E PËRBËRJA ORGANIZUES E VEPRUES E LËVIZJES "VORIOEPIROTE"

Struktura e lëvizjes "vorioepirote" është zhvilluar mbi një bazë të caktuar organizuese, e cila kohë pas kohë ka patur ndryshime, në përputhje me koniunkturat gjeopolitike, të ndjekura nga qeveritë greke ndaj Shqipërisë e më gjerë por pa ndryshuar asgjë në thelb të mëtimeve të tyre për trojet shqiptare. Në qendër e më drejtimit të saj vepron qeveria greke me organet e saja, sidomos me Ministrinë e

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
Zyra Perbarimore Fier me përbarues gjyqësor Arian CEPELE me adresë Lagja "29 Nentori" godina e Gjykatës Fier nga mbrapa, njofton se më date 18.04.2019-02.05.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i 1-rë për shitjen e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr. 7/32 - ZK. 2890, me sipërfaqe 1124 m² me adresë Patos, Fier, në pronësi Z.Haxhi & Gjyle Rrapaj me vlerë fillestare në ankand 4 960 000 (katërmilëneëntëqindëgjatëdhjetë mijë) LEK .
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 697262655.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Zyra përbarimore "BEST 2010"
SHPLLJE ANKANDI
Zhvillim ankandin e parë për pasuritë co.be.in SHPK :
1) a) nr.26/106+1-16, vol.51, fq.242, sip=72 m²; b) Njësi shërbimi nr.26/187-NB/2, vol.56, fq.121, sip=20 m²; c) nr.26/106+1-25, vol.52, fq.1, d) nr.26/187+1-9, vol.52, fq.58 (sip=110 m²).
2. Çmimi fillestar (për pasuritë e përcaktuara në pikën 1) për njësi në shërbim do të jetë 1600 euro/m², ndërsa për tre (apartament) pasuritë e tjera do të jetë 360 euro/m².
Pallati CO.BE.IN, VLORË (përballe Teatrit)
Ankandi zhvillohet më 02.05.2019 pranë zyrës përbarimore "BEST 2010"
Me adresë : Solla; prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës
Mobile: 06920 756 44, Phone/Fax: 052 22 6000
Web: <http://www.perbarimes.al> <www.perbarimes.al>

EPSA SHOOERIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPLLJEN E ANKANDIT PËR :
"Lulishte (Trull)" me sip. 14.700 m², Nr. Pasurie 56/3, Vol.29, Fq.15, ZK 8605, i ndodhur ne Vlorë 5, Vlorë dhe "Objekt karabina 4 Kat + 1 Kat bodrum" me sip. 1.262 m², Nr. Pasurie 56/3-ND, ZK 8605, i ndodhur ne L.11 Janari, Vlorë ne pronesi te Shkolla Internacional shpk. Keto pasuri jane hipotekuar ne favor te Banka ProCredit sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 3.135.524 Euro. Ankandi zhvillohet datë 09.05.2019 ora 16.00 në adresën Rr."1. Qemali", Pall. "Fratar", K.6, Tirane.
Per cdo informacion mund te kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne web www.epsa.al.



Punëve të Jashtme. Në këtë ministri vepron seksioni i emigracionit që drejtohet nga një zv.ministër. Megjithatë de jure nuk qenka, siç thonë, por de facto pranë këtij seksioni vepron sektori i lëvizjes "vorioepirote" "To Dhima Voriopiriu", i cili është pikërisht organi nga ku varet drejtpërdrejt e tërë veprimtaria e vorioepirotëve etj., të këtij kallëpi. Të gjitha orientimet, objektivat e detyrat që i caktohen kësaj lëvizje veçanërisht në Greqi studiohen, përpunohen dhe paraqiten nga ky sektor për miratim qeverisë greke. Pasi miratohen vendimet u dërgohen organizatave në qendër e në bazë për t'i zbatuar. Në krye të këtij sektori ka qenë Jorgo Papadhopulli, me origjinë nga Dervicani i Gjirokastrës. Pra, sektori vorioepirot luan rolin e rëndësishëm në organizimin, drejtimin e ushtrimit e lëvizjes vorioepirote. Këto lidhje janë të kamuflluara më së miri që të mos duket hapur dora e diplomacisë grekomadhe. Kjo lëvizje e quan veten si lëvizje politiko-shoqërore e "pavarur" e vorioepirotëve brenda e jashtë Greqisë. Pas sekretorit vorioepirot në MPJ greke, në detyrë qëndron në krye të kësaj lëvizje "Komiteti i Përpjekjeve Vorioepirote"(QEVA). Ky komiteti përbëhet nga këshilli drejtues: kryetari e 2 nënkryetarë, sekretari i përgjithshëm, 2-3 këshilltarë, 1 arkëtar dhe 5-6 anëtarë. Ky këshill drejtues emërohet më saktë se sa zgjidhet nga qeveria greke, një herë në 3 vjet. Këshilli organizon e përciton në masën e vorioepirotëve orientimet e QEVAs. Secili nga drejtuesit e anëtarët e këtij këshilli drejtues caktohet me detyra të veçanta për zbatimin e të cilave raporton në çdo

mbledhje të këtij këshilli. Më 1982 Këshilli drejtues i QEVA-s kishte: Serafin Tikas, kryetar grek nga Epiri dhe njëkohësisht kryepeshkop i Greqisë, Ilias Konstas, nënkryetar grek, ish-sekretar i kishës greke në Tiranë dhe më vonë drejtues i sektorit vorioepirot në MPJ greke. Kosta Qilqi, nënkryetar nga Delvina, emigrant ekonomik në Greqi. Jani Kamberi nga Policani i Gjirokastrës, sekretar i përgjithshëm, emigrant ekonomik në Greqi. Megjithatë kryesisht e formalisht QEVA ka qenë e mbetet hallka bazë më e lartë drejtuese e lëvizjes vorioepirote, në fakt, ka edhe përçarje e grindje pasi disa degë vorioepirote si brenda por sidomos jashtë Greqisë, ato panepirote, nuk i zbatojnë gjithmonë urdhrat e vendimet e lëvizjes vorioepirote, në fakt, ka edhe dënojnë atë se nuk po i përfaqëson sa e si duhet interesat e vorioepirotëve pasi, sipas tyre, zbaton verbalisht politikën e "butë" të qeverisë greke në marrëdhëniet me Shqipërinë etj. Këto propagandojnë e luftojnë për një vijë më të ashpër kundër vendit tonë për marrjen e Epirit të Veriut. Nga QEVA janë krijuar dhe varen kryesisht të gjitha sillojet (klubet), degët dhe organizatat vorioepirote. Në vitet 1980 në Greqi ishin këto silloje: 1.Athinë-Pire 2.Selanik 3.Janinë 4.Korfuz 5.Follorinë 6.Patra 7.Ekaterinë 8.Bashkimi i delvinojtëve 9.Bashkimi i himariotëve 10.Bashkimi i dropullitëve 11.Bashkimi i korçarëve ose "Sellasforos". Këto klube kishin edhe lidhjet e tyre agjenturore, miqësore e simpatizantë në territorin shqiptar edhe jashtë mjedisit krahinor, siç kanë dëshmuar proceset gjyqësore në vendin tonë nga 1945-1990. Në fillim të viteve 1990 dega e vorioepirit në Korfuz botoi programin e saj dhe ia paraqiti popullit të Himarës duke theksuar se "Kemi krijuar një organizatë të veçantë, të cilës ia kemi vënë emrin: "Himara e lirë vorioepirote dhe minoritarë grekë". Deri në shtator 1992 kemi programuar këto veprimtari: i.vizita të përbashkëta në Korfuz, Janinë, Artë, Pargë, Paramithi, Filat, Himarë, Dhërmi, Palasë, Qeparo, Kudhës, Vuno, Sarandë, Konispol, Dropull. 2.mbledhje të madha në Spile të Himarës ose në Potam me pjesëmarrje të Sebastianos, Janullatos, e Aleko Dhimës, sekretar i përgjithshëm i kishës ortodokse shqiptare. Do dorëzohen 4 priftërinj, mesha të mëdha në katedralet e Himarës e të Dhërmit, ku do meshojnë dhe-potë të Sebastianos e Janullatos. Do flasë edhe prifti dhërminjash, Klerkos Savas i dorëzuar në Athinë. 3.Do nënshkruhet marrëveshje mes kishave për t-i pajisur kishat e vorioepirit e ato të Himarës në veçanti me sendet e nevojshme. 4.Meshat në Himarë, Dhërmi, Palasë, Vuno, Qeparo, Kudhës do

mbahen në greqisht, do të përcaktohen administratorët e krahinës autonome vorioepirote të Himarës, ku do marrin pjesë njerëzit më të devotshëm të familjeve më të shquara si Bollanot, Milot, Neranxët, Josphët, Ilot, Belerajt, Rondajt, Zotajt, Dhi-mojanajt, Dunajt, Anag-nostajt, Protajt, Janilajt, Pjerot, Daflajt, Bifshajt, Gorecajt, Janijajt, Zhupajt, Fotiadhët. Do bëhen mesha përshpirtje për eposin grek 1940-1941 në livadhet e Shëngjergjit e Skutara, ku ndodhen eshtrat e ushtarëve e oficerëve... 5.Do bëhen veprimtari kulturore, traditat nuk harrohen, por forcohen, do shpërndahen libra greqisht, ku flitet për Vorio-Epirin, minoritetin e epopetë...Do flitet për përpjekjet që bën kisha greke për të mos u shpërndarë nga ajo shqiptare, se kurdoherë kanë qenë kundër myslimanizmit e katolicizmit. 6.Do shpërndahen libra shkollore për shkollën greke të Himarës. Me këtë punë do merret familja Bollano, prej të cilës do të caktohen pjesëtarë me detyra me rëndësi në qeverisjen e Himarës, e Bollanot kanë dhënë prova të mëdha për besnikërinë ndaj atdheut të tyre Greqisë (Në fakt, kjo familje e ka origjinën nga Kurveleshi i Sipërm H-L). 7.Në Himarë do vihet radiostacion vorioepirot minoritar që në bashkëpunim me Omonian do të jap programe të pasura të kulturës, muzikës e filozofisë greke për të rrenjosur thellë patriotizmin. 8.Do përcaktohet afati transit i krahinës autonome të Himarës deri në bashkimin me atdheun, Greqinë mëmë. 9.Do vendoset linjë e rregullit detare Korfuz-Himarë, tjetra me autobus grekë Janinë-Himarë dhe udhëtimi i himariotëve vajtje-ardhje do jetë gratis. 10.Në muajin nëntor 1992 do organizohet takim i dytë me proporcione të mëdha (duke u shtrirë gjërë në Tepelenë). Kryetari Ra-failidhis Andrikos, sekretarja Eftalias Papadhimitris! Shënoj se sot në shtëpinë e Rondajve në Himarë ka zyrën "Agimi i Artë". Shovinizëm e racizëm më të pastër nuk ka, po ta provojnë të hanë kokën. Labëria nuk vdes kurrë, kombi shqiptar është në këmbë sidomos sot Shqipëri e Kosovë, nesër të bashkuar më tej në territoret tona etnike, natyrore, historike. Mos u gënjehet mendja, o palikarë kuaj Troje! Kjo dashuri e "vorioepirotëve" me grekët shovinistë është, si thonë labët, e pirdhur dhe e fëndur!

Përveç sillojeve janë krijuar e vepronë edhe organizatat të rinisë vorioepirote, të cilat zakonisht janë vepruese pranë sillojeve përkatëse të vorioepirotëve në rritur. Gjithmonë por sidomos në vitet e fundit po i kushtohet kujdes i madh brumosjes së rinisë me ndjenjat shovene antishqiptare duke krijuar edhe silloje të rinjve në ato qytete, ku nuk ka patur më parë.



Organi tjetër qendror që varet nga QEVA është edhe "Këshilli i Ndhimës Ekonomike", i cili është vendosur pranë sillogut vorioepirot të Janinës. Ky këshill e paraqet veten sikur merret me problemet e ndihmës për të varfrit vorioepirot dhe për organizatat vorioepirote, ndërsa, në fakt, është organ i rëndësishëm i QEVA-s që merret me administrimin e fondeve që ka QEVA për veprimtari kundër Shqipërisë. Ky këshill ka edhe një depo armësh në Janinë e gjetkë afër kufirit tonë, ku ka armatosur gjithnjë vorioepirotët diversantë por edhe sot në raste nevojë militantë apo paraushtarakët vorioepirotë. Pra është një qendër për rast luftime kundër Shqipërisë. Në krye të këtij këshilli në vitet 1980 ishte Spiro Lito, gjeneral i ushtrisë greke në pension, emigrant ekonomik nga Leshnica e Sarandës. Në Igumenicë afër një pylli është ende një zyrë e rëndësishme e zbulimit grek që vepron ndaj vendit tonë në vite, e cila është vizituar edhe nga ish kryeministri Fatos Nano. Organi tjetër qendror i QEVA-s është edhe "Këshilli Ushtrarak", në krye të të cilit ka qenë gjenerali Jorjeto Zoto nga Himara që merrej me organizimin e drejtimin e problemeve ushtarake të lëvizjes vorioepirote. Prej këtij këshilli ushtarak është krijuar edhe grupi i vullnetarëve rezervë vorioepirotë ku janë regjistruar të gjithë vorioepirotët në moshë madhore. Por me gjithë përpjekjet e qarqeve shovene të ndryshme zyrtare e private greke, sidomos nga Averofi e Ralisi nuk është arritur që të krijohet e të forcohet njëshëria ushtarake e radhëve të kontingjentëve vorioepirote për arsye të ndryshme politike e përçarje klanesh për format e metodat e veprimtarisë kundër Shqipërisë. Pranë QEVA-s, si organ vartës i saj, vepron edhe "Komiteti Qendror i Rinisë Vorioepirote", i cili synon ruajtjen e rritjen e ndjenjave shovene antishqiptare tek të rinjtë. Ky komitet drejtohet nga këshilli drejtues i përbërë prej: kryetarit (në vitet 1980 ishte Ilia Zoto, i arratisur nga Himara), nënkryetarit Haralamb Papa nga Saranda dhe sekretarit i përgjithshëm Pilo Mërkuri nga Policani i Himarës, nga ziri i Melina Mërkurit të mirënjohur. Njëpërmjet këtij këshilli QEVA organizon e drejton veprimtaritë e

dendura me të rinjtë duke shfrytëzuar për këto festa e data të ndryshme historike e fetare, ku propagandohet në radhët e të rinjve "lufta heroike" që kanë bërë ballarët e tyre për interesat kombëtare greke, për gjakun e derdhur për çlirimin e Epirit të Veriut etj. Ky organ ka edhe degë në qytete të ndryshme të Greqisë si në Janinë, Patra, Selanik, Korfuz, Follorinë etj. Mes tyre shquhet sillogu i rinisë vorioepirote i Janinës i kryesuar nga Ilia Ajakos grek, armik i betuar dhe agjent i zbulimit grek e CIA, pasi ai zhvilloi njëkohësisht edhe veprimtari të dendur armiqësore kundër vendit tonë në vite. Anëtarët e sillojeve vorioepirote sidomos ata në qytetet e krahinave kufitare me vendin tonë kanë qenë e janë kontingjente të përshatshëm zbulimi e kundërzbulimi, në radhët e të cilëve zbulimi grek e CIA vepronin gjërësisht për studimin, zgjedhjen e përgatitjen e agjenturës që vepron kundër Shqipërisë dhe veçanërisht për ata që janë përdorur e do të përdoren në raste konfliktesh kundër vendit tonë ose si rasti i Peshkopisë në 1994 apo i Kacifas në Bularat. Struktura e organizimave e sillojeve vorioepirote të të rriturëve dhe e të rinjve është e njëjtë me atë të organit qendror QEVA-s. Rezidenturat agjenturore greke në Shqipëri kanë qenë gati kudo në jug të vendit e më gjerë. Vetëm në Himarë një prift rezident kishte rekrutuar 17 vetë, duke u bashkuar nga 3 flori në muaj dhe vetë paguhej 6 flori, të cilët mblidhnin firma të grekomanëve për t'ia dërguar OKB për njohjen e Himarës si pakicë greke. Gjyqet socialiste kanë gjykuar me prova e dënuar plotë rrjete të tilla, veç atyre që janë këshilluar të heqin dorë nga kjo veprimtari armiqësore, pasi kishin të njëjtat të drejta si shqiptarët, punësim, gjuhën, radion e gazetën e vet në gjuhën greke dhe pronën. Çfarë donim më shumë kur janë të barabartë me ne, ndërsa më parë ishin bujq tek bejlerët vendës. Pakica greke mori pjesë në LANÇ dhe pas fitores gëzoi të gjitha të drejtat në të gjithë administratën shqiptare pa dallim. Si nxënës i gimnazit në Gjirokastrë në 1951-1955 dhe më vonë në punë kam qenë dëshmitar i trajtimit të barabartë të bashkënxënësve, përshis edhe nga Bularati, etj., nëpër vend, duke patur të njëjtat përgjegjësi shtetërore kudo. Sot kjo

gjendje s'ka ndryshuar në vendin tonë, veçse u bënë edhe pronarë ligjorë tokash. Lëvizja vorioepirote është e zgjeruar dhe e shtrirë edhe në vendet perëndimore si SHBA, Kanada, Francë, Angli, Gjermania, Turqi, Australi, Egjipt, Afrikë e jugut etj. ku ndodhen të mërguar ekonomikë e politikë nga Epiri i Veriut, nga pakica etnike greke në Shqipëri. Nga këto qendra vorioepirote më tepër vepruese është organizata vorioepirote e ShBA-Kanadasë e quajtur "Konfederata Epirote e Amerikë-Kanadasë" me kryetar në vitet 1980 Minella Xhelasin nga Policani i Gjirokastrës. Në disa raste kjo konfederatë vepron pothuajse e pavarur, jo vetëm nga QEVA, por edhe nga qeveria greke. Vija politike që ajo ka ndjekur është vija e ashpër për ndërhyrje të armatosur e agresion kundër Shqipërisë për të aneksuar "Vorio Epirin" dhe qenë kështu në krye të kësaj lëvizje shovene kundër Shqipërisë. Kërret e saj drejtues herë pas here kanë bërë e bëjnë vizita në Greqi ku marrin takime me personalitete zyrtare greke dhe krerë vorioepirotë atje e gjetkë, me qëllim bashkëpunimi e bashkërendimi të veprimtarisë armiqësore kundër Shqipërisë dhe në diasporën shqiptare ekonomike e politike. Në jo pak raste drejtues të saj kanë kryer provokacione të kufijtë tanë jugorë në vite. Kjo konfederatë ka të njëjtën strukturë organizuese si QEVA dhe prej saja varen degët e ndryshme në Nju York, Çikago, Boston, Detroit, Nju Xherisi, Toronto etj. Kjo lëvizje panhelene me kryetar Kristo Qirkon, me lobin grek në SHBA, nxitën mitet e "Vorio Epirit" në shtypin grek e jashtë tij. Nacionalshoviniستي Nikollas Gage vizitoi Shqipërinë edhe në tragjedinë 1997 si misionar politik e i dërguar për qëllime propagande diversione në shtypin perëndimor në favor të Janullatos e lëvizjes helene në vend e jashtë tij. Janullatos paraqitet si shpëtimtar i ortodoksisë e frymëzues i shqiptarëve të përndjekur. "Askush nuk ka kontribuar më shumë se Anastasi në rilindjen e Shqipërisë si një komb i lirë evropian", tha ish-kryeministri Fatos Nano, duke e ngritur në qiell më mirë se kushdo tjetër (Koha jonë, 27.08.2003). Po në tetor 2003 ndodhi skandali i Himarës, ku shtetas grekë e shqiptarë ngritën flamujt grekë, bënë pyetje e sharje kundër shtetit shqiptar, duke shkëlqur hapur ligjet tona. Kozma Pelo shtetas shqiptar anëtar i PBDN hodhi dinamit e u plagosën njerëz. Nuk u bë asnjë ndëshkim apo identifikim i personave të rrezikshëm. As organizatorët e tyre në Shqipëri e Greqi nuk u zbuluan, por në drejtim të ngjarjeve në Himarë ishin V.Dule e V.Bilano etj.

(vijon në numrin e nesërm)

(Ish-kuadër i lartë i Zbulimit Shqiptar; diplomat dhe pedagog)

NGJARJA

Teatrit Kombëtar i hiqet natën emri, artistët: Barbarët po e shkatërrojnë

Burimet në MK: Nuk është urdhër nga ministria as nga Çuli, po bëhen verifikime

Fatmira Nikolli

Ditën e djeshme godina e Teatrit Kombëtar është gdhirë pa shkronjat që e shenjonin si godinë të teatrit. Germat 'TEATRIT KOMBËTAR' që qëndronin në fasadën e saj në formë vertikale qenë zhdukur dhe ende nuk dihet se kush e ka kërkuar heqjen e tyre as kush e ka bërë. Vetë MK nuk ka dalë në reagim zyrtar, por burime thanë për 'GSh' se "nuk ka qenë urdhër i MK-së as i drejtorit Hervin Çuli dhe se gjatë ditës së djeshme janë bërë verifikime nga MK për germat". Por nga ana tjetër, godina që prej një viti jofunksionale sepse teatri është zhvendosur prej aty për te Turbina, me heqjen e shkronjave duket se 'humb' me emrin edhe një prej shenjimeve të fundit që e lidh me artin. Thënë kjo, artistët që prej një viti kur u prezantua nga qeveria ideja e shembjes së tij për të ndërtaur një të ri po protestojnë për ta mbrojtur kanë interpretuar si hap drejt shembjes.

ALEANCA PËR MBROJTJEN E TEATRIT

Kjo e fundit tha dje se qytetarët e Tiranës u riballën me faktin e kryer: "Fasada e Teatrit Kombëtar u zgjua e dhunuar, e zhveshur nga shkronjat identifikuese të saj. Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit e dënon këtë akt të ulët dhe kërkon nga Ministria e Kulturës të mbajë urgjentsisht dhe publikisht qëndrim për sa ka ndodhur dhe të kujdeset që shkronjat të rivendosen aty ku ishin", shkroi dje Aleanca. Në rast se kjo nuk do të ndodhë, Aleanca do të ndërmarrë një aksion privat për riprodhimin e rivendosjen e shkronjave, dhe do ta denoncojë aktin e paprecedent në prokurori. "Është në nderin e gjithkujt që ka diçka për të thënë, që e ndien veten qytetar dhe shqiptar të flasë dhe të veprjë tani", theksoi Aleanca.

Nga ana tjetër, Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë tha dje se "për të gjithë ata që mendonin se nuk do të vinte kjo ditë, fasada e Teatrit Kombëtar është



gdhire sot pa emërtimin me germa të arta. Mesa duket po bëhet fakt i kryer shkatërrimi i godinës edhe pse ligjërisht nuk ka ende një vendim. Dëmet me të mëdha për trashëgiminë bëhen në kohë trazirash kur vëmendja e publikut është e topitur nga të tjera

hallë". Shkrimtari Rudi Erbara shkroi dje se kur i quajta barbarët, për këtë e kisha fjalën. "Pushues barbarë janë. Natën heqin germa të Teatrit Kombëtar. I vodhën nuk i hoqën për gjë tjetër. Janë mësuar me vjedhje. Vjedhjen e dinë

punë. Janë barbarë. Do t'i hanë fëmijët e vet, sa të rriten, si gjithë barbarët endacakë që janë endur pa vend mbi këtë botë", shkruante në profilin e tij në FB. **REAGIMI I KASTRIOT ÇIPIT**

Më poshtë po vëmë edhe reagimin e Kastriot Çipit,

ish-drejtor i Teatrit të Komeditë dhe pjesë e Aleancës.

Reagimi:

Ndërkohë që shembje tavanit i një dhome në maternitetin "Mbretëresha Geraldinë", duke plagosur dy gra lehona (falë Zotit asnjë foshnjë), nga fasada historike e Teatrit Kombëtar shkuleshin shkronjat ndriçuese.

Injëti shtet, që nuk kontrollon sigurinë e ndërtimeve dhe rindërtimeve të spitaleve, po shkatërron me dhunë objekte të trashëgimisë, që i kanë mbijetuar mungesës së mirëmbajtjes për dekada.

Por, pasi ka kaluar nata e hajrave me rroga shtetërore, skandali sapo ka nisur të shpërfaqet... dhe të thellohet. Drejtori i Teatrit Kombëtar, Hervin Çuli, njeriu që për katër vjet me radhë në post nuk shpenzoi asnjë qindarkë për mirëmbajtjen e ndërtesës, që u rreshtua pro shembjes së saj dhe u shpërblje me një mandat të dytë, e mohoi ngjarjen, prova e së cilës është aty, në zemër të Tiranës, në një shesh publik, ditën me diell. Ai i tha gazetares së një tv-je se "asnjë shkronjë nuk është hequr nga fasada e Teatrit Kombëtar".

Këtu ngrihen ca pikëpyetje të mëdha. Nëse drejtori i TK nuk ka dijeni, kush e dha urdhrin për heqjen e tabelës ndriçuese? Ministria e Kulturës apo Bashkia e Tiranës? Deri tani asnjëri prej këtyre institucioneve nuk është shprehur.

Teatri Kombëtar është në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe asetet e tij janë në pronësi të kësaj të fundit. Bashkia e Tiranës, pra, nuk ka asnjë tagër ligjor dhe nëse ajo është përgjegjëse, atëherë skandali është i dyfishtë.

Por, nëse urdhrin e ka dhënë zënjë ministre e Kul-

turës, mbeten të gjitha pikëpyetjet e tjera: Pse natën? Pse u hoqën shkronjat? Ku ndodhen tani?

Në bazë të ligjit special për "Rindërtimin e Teatrit Kombëtar", Ministria e Kulturës dhe Bashkia e Tiranës duhet të bashkëpunojnë për të shpallur garën për projekte për "zhvillimin urban të zonës" dhe krijimin e komisionit negociator për vlerësimin e tyre. Por këto veprime duhet të bazohen në një Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende, megjithëse afati ligjor ka kaluar qysh më 13 dhjetor 2018.

Atëherë pse u hoq emri i Teatrit Kombëtar nga fasada? A nuk është kjo, në rastin më të mirë, komprometim i garës? Ligji special thotë se i takon komisionit negociator të vendosë për këtë ndërtesë. Kjo do të thotë se komisioni ka të drejtë edhe t'i refuzojë të gjitha projektet e paraqitur në garë dhe, në këtë rast, Teatri Kombëtar nuk ka arsye të shembet. Me këtë veprim, shteti tregon sa seriozisht e merr garën dhe ligjin, institucionet e drejtësisë dhe vetë nocionin e drejtësisë.

Bashkia e Tiranës trumbe-ton me të madhe çdo gjobë për shkelje bari apo urrimin gjatë protestave të opozitës, por nuk ka bërë ende asnjë koment për këtë dëmtim të pronës publike, në zemër të Tiranës dhe në bashkëpunim, të ndodhur para kamerave të Ministrisë së Brendshme dhe më pak se 70 metra larg vetë Bashkisë.

Orët e ardhshme duhet të mësojmë kush e dha urdhrin dhe cilët e zbatuan. Por, nëse Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Kulturës nuk japin asnjë sqarim, atëherë duhet të ndërhyrë prokuroria për të zbardhur të vërtetën.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurinë:

1. "ARE", me sipërfaqe totale 3,820.00 m², e ndodhur në Rrethi KAWAJE, QJF BAGO, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Përllogjueme Kuvajë, Zona Kadastrale: 107Z, Numri i Pasurisë: 124/9, Vol. 3, Fage 17, ne pronësi të Refat Rrahman Estrelli (Refat Rrahman Istrelli).
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpërkshuar, është në vlerën: 9,120,000 (nëntemilione e njëqind e njëzet mijë) lekë.
3. Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë: 05.05.2019 ora 16.16 në Zyren e përbaruesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Përballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Tirana Bank dega Shkoder, në nr logarie 0600-313839-100 CB.

NJOFTIM PËR SHITJE ME ANKAND

Përbaruesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë me të dhenat: me të dhenat: "Trulli-Ndertesë" me sip. totale 202.5 m² dhe nga kjo ndërtesë me sip.65 m², me Nr pasurie 7934, vol 39, fq 125, ZK 8592 e ndodhur ne Lagjen Partizani, Shkoder...e afishuar ne favor te debitorit Izmir Hebovija.
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpërkshuar, është në vlerën: 9,120,000 (nëntemilione e njëqind e njëzet mijë) lekë.
3. Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë: 05.05.2019 ora 16.16 në Zyren e përbaruesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Përballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Tirana Bank dega Shkoder, në nr logarie 0600-313839-100 CB.

NJOFTIM PËR SHITJE ME ANKAND

1. Përbaruesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë me të dhenat: "Ndertesë njëkateshe industriale" me nr pasurie 107/ND, Volumi 24, Fage 143, me sipërfaqe ndërtime 1 235 m², Zona kadastrale 8592, e ndodhur tek zona industriale e qytetit, pjesë e ish parkut te mallrave, Shkoder...e regjistruar ne favor te Altin Salihit etj
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpërkshuar, është në vlerën: 24,240,000 (njzetete kater milione e dyqind e katerdhjetë mijë) lekë.
3. Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë: 03.05.2019 ora 16.16 në Zyren e përbaruesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Përballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Tirana Bank dega Shkoder, në nr logarie 0600-313839-100 CB.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 658

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHOIPTARE Redaktore: Pamela ALIAJ - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 27 Prill 2019

ALESIA BAMI: Kush më propozoi dhe sfida ime e re si moderatore




**U largua nga Klani,
Rrëfëhet ish-velina:
Kam patur shumë oferta,
ja pse zgjodha "E Diell".
Do kem kohë për gabime,
por, nëse marr një vendim,
nuk pendohem kurrë**

EDJON HYSEJNAJ

Mori pjesë tek "Dy gisht
mjaltë". "Pasioni im për
aktrimin dhe modën"



**SËRISH NË NJË SERIAL
BASHKË, NIK XHELILAJ
I LIDHUR ME AKTOREN
E NJOHUR TURKE?**



Të famshëm dhe në botë! Firma e njohur e veshjeve përdor plisin shqiptar për koleksionin e ri

Kemi vënë re se veshjet kombëtare shqiptare jo rrallë herë kanë qenë të përdorura nga marka të njohura botërore si detaje të koleksioneve të tyre duke qenë se janë vetë unike në llojin e tyre. Më parë dolën bluzat, të cilat mbanin simbolin shqiptar – shqiponjën dykrenare që u bënë të famshme në Brazil. Këto rroba kishin filluar të pëlqeshin edhe nga personalitetet e njohura në atë vend si ish-sulmuesi i Milanit Alexandro Pato, i cili kishte publikuar në 'Instagram' një fotografi ku luante me qentë ndërsa ka të veshur një bluzë të bardhë me shqiponjën në gjoks. Edhe marka prestigjioze zvicerane e orëve CVSTOS kishte prodhuar orën me simbolin shqiptar atë të shqiponjës dykrenare. Së fundmi, marka e njohur amerikane e veshjeve, Marc Jacobs ka zbuluar koleksionin e ri të veshjeve ndërsa në njërin nga veshjet si aksesor e ka shtuar plisin që është qeleshe tradicionale shqiptare dhe pjesë e çdo veshjeje kombëtare të burrave. Super apo jo?



Moderatori e pyet për klikimet, flet Madonna: Unë nuk i blej, këtë e bëjnë shqiptarët

Ditën e enjte bënë bujë të madhe deklarata të ndryshme, të cilët kritikonin artistët shqiptarë duke thënë se i blejnë klikimet pasi marrin miliona të tilla brenda orës. Të shumtë ishin ata që menduan se kjo deklaratë e tyre ishte një thumbim për këngëtarën Dhurata Dora dhe këngën e saj të fundit, e cila ka kapur shumë klikime në Youtube. Mirëpo lidhur me këtë deklaratë ka reaguar së fundmi edhe moderatori i emisionit "Trokit", Ermal Peçi. "3 milionë për 24 orë? Kaq pak për 2 emrat më me influencë? Këngëtarët tanë shkojnë miliona për një orë Madonna do ndihmë?", ka shkruar ai duke e etiketuar Madonën dhe Malumën. Më pas Ermali ka thënë se Madona i ka kthyer përgjigje në lidhje me këtë postim. "Hey Ermal, unë nuk pëlqej të blej klikime, e di është tendencë shqiptare, po jo për mua" shkruan Madonna. Ja një thumbim i vërtetë nga ikona e kënaës botërore




Hey Ermal, i dont prefer to buy views... i know... it's an albanian tendence but not for me!

emadonna thank you!!
We Love u
Madonna



Sërish në një serial bashkë, Nik Xhelilaj i lidhur me aktoren e njohur turke?

Së fundmi, aktori i njohur me origjinë shqiptare, Nik Xhelilaj është kthyer në një nga figurat më të dashura në Turqi. Ai ka luajtur në disa produksione turke, ndër ta dhe në filmin 'Kayip Sehir' në vitin 2012, krah aktore Gokçe Bahadır. Por sipas mediave të ndryshme dyshohet se në të njëjtën periudhë kur dyshja kanë punuar krah njëri-tjetrit, kanë qenë dhe në një lidhje në jetën reale. Kujtojmë se aktorja e njohur ka qenë e martuar për 1 vit me Ali Sunal dhe është divorcuar prej tij pikërisht në vitin 2012. Pas 7 vitesh nga spekulimet për një lidhje të mundshme të Xhelilaj dhe Bahadır, nuk dihet se çfarë raporti gëzojnë dy aktorët aktualisht.



Një i dashur romantik si Alfio! Ja ç'suprizë i bën Fatmës sa zgjohet

Ata janë kthyer në çiftin më të bukur dhe të komentuar të momentit, kjo pasi që në momentin që bënë publike lidhjen e tyre, surprizat nuk kanë pasur fund. E kemi fjalën për çiftin Alfio Rrotani dhe Fatma Methasani. Së fundmi, moderatorja ka publikuar një foto në 'Instastory' ku ka zbuluar se partneri i saj e ka surprizuar me një mëngjes shumë të ëmbël në shtrat. "Çuni i surprizave", ka shkruar mbi foton ku duket se Alfio i ka përgatitur asaj mëngjesin, megjithatë çfarë tërhoqi vëmendjen ishte prania e disa trëndafilave të kuq. Kujtojmë se Fatma dhe Alfio e bënë publike lidhje pas 2 vitesh dhe tani, dyshja jeton së bashku.



E akuzoi për operacione plastike, Rike Roçi jep reagimin epik ndaj fanses

Padyshim që Rike Roçi është një nga femrat më të bukura të showbiz-it shqiptar dhe gjithmonë tërheq vëmendje me fotot që publikon në rrjete sociale. Ajo u bë e njohur nga pjesëmarrja në 'Big Brother Albania', mirëpo



a jo ende vazhdon të komentohet për sa i përket pamjes fizike edhe tani që është larg kamerave të televizionit. Së fundmi, një nga ndjekësit e saj e ka akuzuar për operacione plastike, duke i shkruar: "Hë mi se dhe ti e bërë je. Ke bërë hundën, gjoksin", gjë që e ka acaruar shumë atë. "Ja mi shoqe e dashur në mëngjes kjo foto, çfarë shihet të bërë t'i këtu? Apo jeni mesuar duke parë që janë të gjithë të bërë dhe nuk ju besohet më kush është natyrale vërtetë... nuk kam asgjë të bërë unë", ia ka kthyer Rike, duke e sqaruar njëherë e mirë këtë situatë që mesa duket ishte e përsëritur.

Një tjetër dasmë në horizont! Rrëfëhet Bojken Lako: Do bëjmë dasmë, por do jetë e çuditshme

Së fundmi kantautori i njohur, Bojken Lako, ishte i ftuar special në emisionin "Rreze dielli". Ai ka treguar detaje të shumta rreth karrierës dhe jetës së tij private, veçanërisht për lidhjen disavjeçare me këngëtare Semi Jaupaj. Ai ka zbuluar se po mendon që së shpejti të krijojë një festival, "Bulza Festival" për promovimin e artistëve të rinj. Më tej Bojken ka shtuar se partnerja, Semi, ka pasur ndikim shumë të madh tek ai dhe ka qenë mbështetja më e madhe e tij në çdo aspekt. "Gjatë gjithë këtyre viteve jam mbështetur shumë te Semi dhe kam marrë një lloj drejtimi dhe orientimi shumë të mirë, sepse e kam konsideruar si njeriun që edhe ana profesionale e shijeve të veta, por edhe si publik, sepse ajo ka dëshirë që të më shohë si publik i thjeshtë", ka thënë kantautori. Për sa i përket planeve private, Bojken ka treguar se do të bëjnë një dasmë, e cila duhet të jetë shumë speciale. "Normalisht do të bëjmë dasmë, por ashtu siç i bëjmë gjërat e çuditshme, mbase do bëjmë ndonjë gjë të çuditshme atëherë kur duhet, ose do jetë mirë për të bërë diçka speciale. Normalisht që çdo njeri ka dëshirë të bëjë një ceremoni që ta mbajë mend me njeriun e tij të zemrës", ka thënë ai.




I habitën të gjithë në "The Voice of Italy", Binjaket shqiptare: Pse zgjodhëm të këndojmë shqip

Pas performancës në "The Voice of Italy", motrat Ina dhe Serena, të cilat komentuan shumë për performancën e tyre, ishin dje për herë të parë në një intervistë për Klubin e Mëngjesit. Të 4 këngëtarët coach të këtij talent show kanë kërkuar që grupi Sindalls të bëhet



pjesë e skuadrave të tyre. Por motrat shqiptare për shkak të afërsisë së stilit të tyre muzikor kanë preferuar skuadrën me trajner këngëtarin rap Gue Pequeno.

Të pyetura se pse zgjodhën pikërisht këngën "Shum pis" të Era Istrefit për të interpretuar thanë se: "Donim një këngë shqip për ta bërë më të njohur muzikën shqiptare në Itali por edhe për faktin që Era Istrefi është tashmë një yll ndërkombëtar". Të pyetura nëse do donin të ecnin në rrugën e Elhaida Danit, e cila vite më parë u shpall edhe si fituese e "The Voice of Italy", këngëtarët thanë se e synonin patjetër këtë gjë. "Elhaida u prezantua me një tjetër stil dhe ishte me profesioniste, por padyshim që dhe ne e synojmë fitoren në "The Voice", edhe pse lëvrojmë në një tjetër stil. Motrat u shprehën se edhe në fazat në vijim kanë dëshirë të këndojnë në gjuhën shqipe. Programi televiziv "The Voicy of Italy" 2019 transmetohet një herë në javë në Rai 2 e drejtohet nga prezantuesja e njohur Simona Ventura.



Modelja pozon me të brendshme, e dashura e Feros tregon linjat perfekte

Ajo është bërë e njohur për publikun si e dashura e reperit Fero. Por krahas kësaj, Arbenita Ismajli njihet edhe si modele në Londër ku prej disa vitesh ushtron këtë profesion. Madje ajo ka një vit e gjysmë që është pjesë e kompanisë "Elite". Së fundmi, bukurshja ka publikuar dy fotografi ku shfaqet vetëm me të brendshme të markës "Calvin Klein", duke nxjerrë në pah gjoksin seksi. Edhe pse e shohim shpesh me fotosesione të reja, modelja shqiptare merr 2 mijë euro për një të tillë. Kujtojmë se Arbenita Ismajli është nga Shkupi që ka vite që jeton në Londër, por edhe vizitat e shpeshta në vendlindje nuk mungojnë.

Rrëfëhet ish-velina: Kam patur shumë oferta, ja pse zgjodha "E Diell"

U largua nga Klani, flet

ALESIA BAMI:

Kush më propozoi dhe sfida ime e re si moderatore

"Do kem kohë për gabime, por, nëse marr një vendim, nuk pendohem kurrë"

Pamela Aliaj

Para pak kohësh u përfol shumë nëpër media ikja e saj si velinë e "Stop" në Klan TV. Por shumë shpejt modelja Alesia Bami u pa të ishte pjesë e emisionit të së dielës në Top Channel, "E Diell". Jo vetëm kaq po shumë ndryshime të tjera ndodhën me largimin nga pozicioni i velinës, duke marrë një rol të ri, atë të moderatores. Në një intervistë ekskluzive për "Blue-tooth" të "Gazeta Shqiptare", Alesia Bami na rrëfen prapaskenat e projektit të ri, surprizat që pret t'i ndajë me ndjekësit e saj si dhe risinë në ndërmarrjen e re në fushën e marketingut. Si erdhi propozimi për tek "E Diell"? Pse zgjodhi pikërisht TCH dhe cilat janë surprizat që pret t'i shfaqë së shpejti? Për më tepër në intervistën e mëposhtme.



Tashmë prej disa muajsh jeni pjesë e 'E Diell'. Si erdhi propozimi për të qenë pjesë e këtij formati?

Propozimi erdhi nga vetë Manushi për të qenë pjesë e "E Diell".

Pas largimit nga Klan keni patur oferta të tjera? Pse zgjodhët pikërisht Top Channel?

Kam patur oferta të ndryshme dhe nga televizione të tjera. Zgjodha Top Channel, sepse mendoj se përshatam më shumë.

Ju kemi parë të jeni pjesë e fotosesioneve të ndryshme në 'Instagram'. Për çfarë bëhet fjalë konkretisht?





Bëhet fjalë për hapjen e biznesit tim të ri "Elegance by AlesiaBami". Fotot janë realizuar për të reklamuar fustanet e mbrëmjeve që ndodhen në showroomin tonë. Jam kujdesur që ta gjejnë veten të gjitha vajzat me fustanet që kam përzgjedhur.

Cili është projekti i radhës i Alesias në fushën e modelingut?

Preferoj ta lë surprizë.

Me cilën nga personazhet shkon më mirë tek 'E Diell'?

Jemi në harmoni me gjithë stafin së bashku. Më mirë shkoj me Florin pasi kemi dhe rubrikën 'Escape' (Mbatja),

bashkë dhe ruajmë marrëdhënie shumë të mira.

A ka ndodhur të ketë ndonjë zënkë të vogël prapa kuintave? Kush është ajo/ai më paqësori që i qetëson gjërat?

Duke qenë se jemi një grup i madh tek "E Diell", normalisht ka edhe keqkuptime të vogla, por që nuk zgjasin shumë. Personi më paqësor, që na qetëson të gjithëve dhe, që është shumë e thjeshtë të punosh është Manushi.

Për çfarë studion Alesia? A e sheh të ardhmen si pjesë e tv apo e shkollës që ke mbaruar?

Unë aktualisht studioj për



jet apo shoqërinë tënde?

Përveç menaxheres time që është shumë e rezervuar për të mos patur dalje të shumta televizive të tipit "interview", s'ka asnjë njeri tjetër në jetën time. (qesh)

Cila është muza juaj apo shprehja që ju frymëzon çdo ditë?

Don't give up! "Mos u Dorzo!"

Cili është gabimi më i madh për të cilin jeni penduar?

Mendoj që do kem kohë për gabime. Por, nëse marr një vendim, nuk pendohem kurrë.

Cili është personi që ju ka suportuar më tepër në ëndrrat dhe rrugëtimin tuaj?

Është familja ime, më shumë babai im të cilin e falënderoj pafund!

aktrim. E shoh veten pjesë e të djave.

Je gjithmonë në formë perfekte të trupit. Cila është dijeta apo rutina jote e të ngrënit?

Aktivitetet e mija janë të shumta. Mbase kjo është arsyeja që më ndihmon të jem në formë.

A është dikush në jetën tuaj? Është xheloz në dal-

Pamela Aliaj

Të jesh model është shumë e vështirë në ditët e sotme për të patur sukses të çash në botën e modës. Por, nëse bëhet fjalë për dikë që ka më tepër se një pasion, tek ai ndërthuret arti, duke qenë se po mbaron studimet për arkitekturë, moda, duke qenë se është figurë e njohur e fotosesioneve të ndryshme të markave të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe aspiron edhe në fushën e kinematografisë. Pra, me kaq shumë pasione dhe dëshira për t'i provuar nga pak dhe për të shkëlqyer në njërin prej tyre, na paraqitet Edjon Hysej. Djali bukurorsh që e keni parë të jetë figuranti tek kënga "Baladë" e Enca Haxhia, apo edhe në rolin dytësor tek "Dy gisht mjaltë". Djaloshi nga Shkodra është duke përfunduar provimet, por ëndrrat dhe pasionet e tij i ka të qarta dhe synimet të përcaktuara. Në një intervistë për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Edjoni na rrëfen eksperiencat e tij në këto fusha të ndryshme si dhe ku e sheh veten më mirë në të ardhmen. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.

Jeni model, por jeni duke mbaruar një shkollë që nuk ka lidhje me fushën e modës. Ku e gjen më tepër veten Edjoni?

Po mbyll studimet për arkitekturë. Pavarësisht se janë dy fusha të ndryshme, moda me arkitekturën lidhen me të bukurën dhe estetikën. Të them të drejtën është pak e vështirë të vë gishtin te njëra, sepse më pëlqejnë shumë. Por për mua parësore kanë qenë gjithmonë studimet.

A i keni nisur hapat e para në fushën tuaj e arkitekturës? Çfarë lloj profili ju pëlqen më tepër?

Kam filluar të praktikohem në projekte të ndryshme. Nga interierët që janë më të lehta, deri te projektimi i eksterierëve dhe fasadave me komplekse. Kam kaluar shumë punë të ndryshme dhe kam marrë eksperiencë për sa i përket zbatimit të projekteve. Projektimi i jashtëm i objekteve më pëlqen më tepër se interieri, sepse kërkon më shumë njohuri dhe përgjegjësi.

Jeni shkëputur nga rrjetet sociale duke hapur një llogari të re. Pse nuk preferoni ta reklamoni veten apo edhe punët tuaja?

Jam shkëputur, sepse kisha një adresë të vjetër pa rregull dhe me shumë njerëz që as nuk ia kisha idenë se kush ishin. Është më mirë një rreth më i vogël me njerëz që



Rrëfëhet modeli: Projektet e mia të reja me markën e njohur amerikane

EDJON HYSEJNAJ

Mori pjesë tek "Dy gisht mjaltë".
"Pasioni im për aktrimin dhe modën"



"Kam një ëndërr që kushton shumë më tepër se gjumi im"

kuptojnë mënyrën tënde të jetesës. Nuk kam reklamuar punë, sepse nuk janë në postimet që vlerësohen më shumë pavarësisht vlerës që kanë. Për të është më mirë një faqe më vete.

Me çfarë po merret konkretisht Edjoni tani?

Konkretisht po përgatitem për temën e diplomës si dhe po shoh për eksperiencën të reja jashtë profesionit. Më pëlqen diversiteti dhe nuk jam person që mund të rri i ndrydhur me orë të tëra në zyrë.

Ju keni parë të ishit pjesë e këngës së këngëtares Enca, "Baladë". Si është të punosh me të? Si erdhi propozimi?

Po, është një nga punët e fundit që kam bërë si model. Ishte eksperiencë ndryshe pasi në përgjithësi kërkohet më tepër aktrim në xhirime. Unë nuk e dija fare ç'behej para kamerës derisa kam parë klipin. Ishte kënaqësi të bashkëpunoja me Encën. Nuk ishte hera e parë që takoheshim, por kësaj radhe ishte për klipin. Është një person me shumë humor dhe energji. Propozimi erdhi, në fakt, nga një mikeshë e përbashkët dhe nuk hezitova ta pranoja.

Cili është pasioni juaj më i madh? Sa shumë do investoni (jeni duke investuar) për ta ndjekur?

Pasioni im është aktrimi kinematografik. Pavarësisht se në Shqipëri nuk kemi shumë produksione



filmash, mua më tërheq shumë. Madje kam marrë pjesë në disa prej tyre me role dytësore si dhe episodike. Filmi i fundit që kam marrë pjesë ishte "Dy gisht Mjaltë". Një nga synimet e mia është të provoj integrimin me tregun e huaj. Prandaj jam përgatitur mirë me gjuhën gjermane dhe angleze. Është një nga qëllimet që i kam vënë vetes.

Si model që jeni ju pëlqen edhe fusha e modës në veçanti mënyra e të veshurit me stil që ju nxjerr në pah personalitetin tuaj. Cili është outfit-i i preferuar i juaji?

Për sa i përket stilit të veshjes, unë e gjej veten tek klasikja. Në përgjithësi jam tipi i kamishave, xhaketave e palltove, me këpucët e lëkurës dhe pantallonat slim. Kam mbledhur një koleksion me këmisha dhe xhaketa sepse nuk i rezistoj dot kur dal për shopping. Në ditë që dua më tepër rehati apo thjesht të jem më i thjeshtë, dal edhe me 'street style', por shumë thjesht. Nuk jam fans i gjërave ekstravagante, s'dua bluza me stampime apo imitime. Bluza jake V njëngjyrëshe me xhinse dhe atlete, thjeshtë, janë ato që preferoj më mirë.

Tek një femër çfarë shihni në veçanti në mënyrën e të veshurit? Elementi që sipas jush nuk duhet të mungojë tek ajo?

Femrat kanë një përparësi sepse kanë një garderobë më të gjerë se meshkujt. Më pëlqejnë femrat që preferojnë një stil casual me xhaketa dhe pantallona dhe këmishë. Më pëlqen shumë ky stil tek femrat në përditshmëri. Pastaj për mbremje dhe raste tjera, normal që fustani i shkurtër i zi është një pikë e dobët për të gjithë meshkujt. Mendoj që një femër duhet të mbajë gjithmonë aksesore qofshin ato byzylykë, varëse apo vathë.

A ju kanë propozuar së fundmi të jeni pjesë e ndonjë projekti? Nëse po, për çfarë bëhet fjalë konkretisht?

Në fakt, po. Pres të konfir-



moj një bashkëpunim me disa firma veshjesh në USA. Për t'i bërë reklamim përmes 'Instagramit'. Si dhe të bëhem një përfaqësues marke për to. Është e vështirë të çash në tregun online këtu në Shqipëri pasi

pjesa më e madhe e blerjeve bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Cili është bashkëpunimi që ju ka lënë më tepër mbresa në punën tuaj? Pse?

Mund të them që ishte bash-

këpunimi me stilistin Altin Mici. Xhirimet dhe fotot ishin në qytetin tim të lindjes, në Shkodër dhe kjo më pëlqeu shumë. Gjatë setit kam krijuar miqësi të mirë. Jemi bërë si grup i pandashëm. Gjithashtu, edhe sukcesi i komplet reklamës është një pro me vete. Nga aty kam krijuar më tepër njohje dhe kam marrë edhe punë të tjera.

A keni menduar të zhvilloni të ardhmen jashtë vendit? Ku e shihni veten, nëse po?

Është diçka që më kalon në mendje çdo ditë. Dhe po pres të mbyll studimet. Një nga shtysat është "living the

american dream". Është vendi i mundësive. Është një rrezik që dua të marr përsipër për ta provuar. Gjithashtu Gjermania është një vend që më pëlqen shumë. Nga aspekti ekonomik, historik dhe mënyra e jetesës.

Cila është shprehja apo muza që ju frymëzon çdo ditë të jetës suaj?

Është një shprehje që më ka ndihmuar të ec përpara: "Kam një ëndërr që kushton shumë më tepër se gjumi im". Kjo shprehje shkon për të gjithë ato net pa gjumë që më kanë ndjekur në 5 vitet e shkollës.



Opinioni *i* Ditës

Kapitull i ri për presidentin Macron

Nga Barbara Wesel

(vijon nga faqja 1)

...me ta në tavolinë dhe shpjegoi çfarë do të bëhet pas muajve të protestave të "Jelekëverdheve" në Francë. Kështu, ai hoqi dorë nga ideja e përsëritur e mbajtjes së distancës dhe pranoi se kryetari i shtetit duhet të flasë me qytetarët.

DHURATA PËR PROTESTUESIT

Me fillimin e vitit, kur udhëton nëpër Francë për të folur me mijëra qytetarë, përfaqësues të popullit dhe kryetarët e bashkive, ai ka mësuar shumë për vendin e tij, pranon Macron. Ka mësuar që ekziston ndjenja e përgjithshme e padrejtësisë sociale dhe financiare.

Për të luftuar këtë, ai ka marrë një tufë masash: ulje të ndjeshme të taksave për njerëzit me të ardhura të mesme, rritje të pensionit minimal dhe rifutjen e kompensimit të inflacionit për të ardhurat e të moshuarve, njohje më të mirë për punën që bëjnë gratë në kujdes të familjes, si dhe për nënat që i rrisin fëmijët të vetme.

Të gjitha këto janë dhurata që kryetarët e shteteve ua japin shpesh qytetarëve në fushata zgjedhore. Macron po e bën këtë dy vjet pas hipjes në post, sepse kërkon të ndryshojë mendimin që francezët kanë për të dhe të çojë më tej modifikimin e shtetit, të cilin e ka premtuar. Dhe këtë ai nuk është në gjendje ta bëjë me protestat e vazhdueshme dhe rezistencën që i bëjnë qytetarët. Presidenti i drejtohet shumicës së moderuar të popullit të tij. Me banditët që kanë mbetur mes "Jelekëverdheve" duhet të merret policia, këtu ai ka të drejtë.

REFORMA ADMINISTRATIVE DHE



ARSIM MË I MIRË

Macron pranon se ka bërë edhe gabime, ai u është dukur të tjerëve i distancuar dhe arrogant dhe premtonte të përmirësohet. Prezantimi që bëri ishte marshimi personal për në Canossa, me shpresën që të hapë një kapitull të ri në presidençën e tij.

Në Francë akuzat për elitat e fryra janë shtuar, dhe me të drejtë. Epiqendra janë kritikuar për shkollën elitare ENA, ku ka mësuar Macroni vetë dhe shumë presi-

dentë dhe ministra francezë. Tani ajo do të reformohet, nëse nuk mbyllet fare. Ky është rezultat direkt i kritikave të bëra nga "Jelekëverdhet". Përveç kësaj, do të ketë një reformë administrative, do të ulen numri i funksionarëve në Paris dhe shumë prej tyre do të dërgohen në provinca.

Kjo është zgjidhje përgjysmë. Ajo që i duhet Francës është decentralizimi i përgjithshëm, ku pushteti nga kryeqyteti të kalojë në rajone. Më shumë vendime politike duhet

të merren nëpër rajone. Kjo do të ulte pakënaqësitë, ndjenjën e përhershme që fjalët venë në vesh të shurdhët dhe do të shkarkonte presidentin nga akuzat, sepse njerëzit do të tregonin me gisht ata që janë përgjegjës në provinca.

PLANI FINANCIAR I MACRONIT, I MJEGULLT

Qeveria qendrore franceze, e cila sundon mbi çdo gjë, është e modës së vjetër dhe duhet demokratizuar. Por, Macron me reformat e tij nuk guxon të bëjë shumë. Ai premtonte

përmirësimin e shkollave dhe të arsimit. Por, edhe këtu kemi të bëjmë me transformimin e strukturës së sistemit. Sistemi francez i shkollave duhet të jetë më pak hierarkik, më i hapur dhe më modern.

Por, do të ishte e vështirë për presidentin e vendosur që të tërheqë në shekullin e 21 popullin e tij, të cilit i mungon vullneti. Si në çdo fushë tjetër, Macroni mund të hedhë në këtë drejtim hapat e para. Francezët që nuk kanë vullnet për reforma nuk lejojnë të bëhen shumë gjëra. Këtë ata e treguan muajve të fundit, kur dolën nëpër rrugë.

Nuk është shumë e qartë çështja e financimit të bamirësive të premtuara për rritjen e pagës minimale dhe pensioneve të ulëta dhe uljen e taksave për shtresën e mesme. Macron thotë se do të mbyllë vrimat e taksave dhe do të reduktojë administratën, por kjo nuk mjafton. Shenjat tregojnë se do merren borxhe të reja.

A mjafton për të marrë kthesën?

Kur të bëhen të qarta detajet dhe francezët të mësojnë sa para ka Macron në xhepa për bamirësitë, atëherë atmosfera do të përmirësohet. Që pas debatit kombëtar, u rritën vlerat në sondazhe. Presidenti është komunikues i mirë, duket simpatik dhe i afërt. Nëse e përdor edhe më shumë këtë cilësi, atëherë do të jetë në gjendje të bindë për reformat një pjesë të qytetarëve të moderuar. Megjithatë, francezët kthejnë sipas erës, të pajisur me genin e revolucionit dhe pretendime të mëdha. Nuk duket të jetë e lehtë që t'i mbash me humor. Dhe presidenti Macron është në provë. Atij nuk i lejohej të bëjë gabime të mëdha. Mbas ditës së sotme, ai qeveris në kushte të rënda dhe nëse do jetë në gjendje të bindë popullin e vet, pritet të shihet.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

Opinion i Ditës

Nga Veton Surroi

(vijon nga faqja 1)

...të shekullit të kaluar, atë të Thomas Kuhn, "Struktura e revolucioneve shkencore". Nuk është përzgjedhja për të filluar shkrimin me të cituar librin vetëm pse kur po e shkruaj këtë shkrim është Dita e Librit apo se është në mesin e "100 librave më me ndikim të shekullit XX" të suplementit kulturor të "New York Times", por pyetja që të prekë gjenden në tri shoqëritë shqiptare nëpërmjet tezës themelore të këtij libri.

Teza në fjalë është se ndryshimet në shkencë (pra edhe në njohuritë shoqërore në tërësi) nuk ndodhen në formë graduale me akumulimin e njohurive, por me ndërhyrjen e herëpashershme të ideve e interpretimeve të reja (të quajtura "lëvizje paradigmatike") që vendosin një nivel të ri të njohurive. Rrjedhimisht me tezën e autorit, që për shembull të "paradigmës së re" merr momentin kur njerëzimi kalon prej interpretimit të sistemit qiellor të Ptolomeut në atë të Kopernikut, shtrohet pyetja te tri shoqëritë shqiptare dominuese - Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni - se a mund t'i kuptojmë ende këto shoqëri me njohuritë e deritanishme (paradigma e vjetër) apo jemi në prag të një risie.

2. Disa risi - e unë do të veçoj dy - ndodhën në Maqedoninë Veriore me kandidaturnë e Blerim Rekës për president të këtij shteti. E para ishte paraqitja e një diskursi të një shqiptari urban që theu akullin e paradigmatës së vjetër se është e nënkuptueshme që presidenti i vendit nuk mund të jetë një shqiptar, gjegjësisht se një shqiptar e ka të paracaktuar detyrën e vet pothuajse kushtetuese-juridike, e ajo është të merret vetëm me çështjet e shqiptarëve. Risia e dytë ishte se ky kandidat u paraqit fillimisht si i pavarur, pra jo si pjesë e establishmentit politik. Pas numërimit të votave, del se ka hapësirë bukur të pambuluar politike të atij që njihet si establishment politik shqiptar. Tetëdhjetë mijë votat dhënë Blerim Rekës janë potencial i madh i ndryshimit brenda skenës politike shqiptare, por ç'është po aq me rëndësi, edhe të raportit tradicional mes partive shqiptare dhe atyre maqedonase. Raporti i vjetër, posaçërisht i solidifikuar gjatë pushtetit të kryeministrit Gruevski, ishte ndarja etnike e shtetit të kapur në proporcion; çdo gjë që ishte hapësirë publike që një tortë e madhe për t'u ndarë nga anëtarët e koalicionit.

Dalja e një lojtari në skenë e që nuk kontrollonhet nga paradigma e vjetër nuk është vetvetiu paradigmatë e re, por demonstron se ka mundësi për një të tillë.

3. Shqipëria nuk është duke prodhuar paradigmatë të re. Është duke e konsumuar atë të vjetrën. Nëse për një moment i mbyll sytë dhe i heq etiketat partiake të folësve në skenë publike do të dëgjosh një kontinuitet. Ata që

A po ndodh një risi në botën shqiptare?

Filizat e risive në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë Veriore?



janë në opozitë akuzojnë ata që janë në pushtet për manipulim zgjedhor (vjedhje votash) dhe për korrupsion (vjedhje parash). Ata që janë në pushtet akuzojnë opozitën se po përpiqet ta marrë pushtetin pa votë, në rrugë e nëpërmjet protestave. Që të dy thonë për njëri-tjetrin se janë zhytur në krim.

Megjithatë hera e fundit që është vendosur paradigma e re ka qenë me vendosjen e sistemit shumëpartiak, Shqipëria ka përjetuar që çdonjëra prej garniturave që sot akuzojnë njëra-tjetrën qoftë për vjedhje votash e parash në pushtet, qoftë për synim për ta fituar pushtetin pa votë, të jenë në pushtet.

Ka vend për një paradigmatë të re? Dy janë indikatorët potencialë që dëgjojmë gjatë javës në Shqipëri. Një, komuniteti i biznesit është i brengosur me paralizën politike. Në tranzicion, komuniteti i biznesit ka qenë aleat i madh dhe ndoshta i detyrueshëm i paradigmatës së vjetër; ka qenë dhe është financuesi i drejtpërdrejtë i sistemit të korrupsionit në vend, duke e konsideruar përqindjen e profilit që duhet dhënë pushtetarëve si kosto prodhimi, që në fund edhe ashtu do ta paguajë konsumatori. Për më tepër, ka konsideruar se edhe krimi i organizuar, i cili sjell të ardhura të jashtëzakonshme nga tregtia me drogë, është pjesë e njëritës ekonomike të vendit. Logjika qese para nga droga, fundja, kthehen në vend si kapital investues.

Tash ky komunitet ka nevojë për një siguri që nuk varet prej balancës së krijuar me pushtetin nëpërmjet të rryshfetit e as nga balanca e krijuar të respektit të ndërsjellë me krimin e organizuar. Afarizmi në Shqipëri ndihet i rrezikuar nga viktima e radhës para parlamentit në emër të mbrojtjes së demokracisë apo viktimit e radhës të anëtarëve të bandës në klub lagjeje në emër të mbrojtjes së linjave ndarëse të territoreve të bandave të drogës. Afarizmi, kryesisht në ndërtim dhe turizëm, ka hyrë në cikël zhvillimor të atillë që prej shtetit nuk kërkem më as kushte më të mira, as infrastrukturë por, mbi të gjitha, siguri dhe stabilitet.

Sinjali i dytë është nga komuniteti intelektual. Ai është konsumuar prej vitesh duke mbrojtur herë njërin palë e herë palën tjetër në konfliktin politik, dhe jo pa të drejtë. Përgjatë tërë viteve të përplasjeve politike zëri protestues opozitar ka nxjerrë në sipërfaqe padrejtësitë që i bëhen atij në opozitë dhe favoret që iu bëhen njerëzve në pushtet. Problemi tek i cili po mbërrihet tani është identifikimi se nuk janë vetëm problem kjo apo ajo udhëheqje e vendit, por problemin duhet kërkuar në sistemin. Sistemi i njëjtë ka gjasë të prodhojë vetëm rezultat të njëjtë.

Ndeshja e radhës politike mund të jetë rast i mirë për të vazhduar brenda sistemit, me antagonizëm të mëtejshëm, apo mund të jetë edhe rast për një përllogaritje të esllt se çka është ajo që do ndërruar në këtë vend?

4. Dhe, dy sinjale paradigmatike janë në Kosovë. Kuvendi i Kosovës, me gjithë insistimin e shumicës që të bëhet një çajtorë e madhe e kotësive zhillore, megjithatë është duke dënuar njërin prej hetimeve, me komisionin e vet, i cili mund të shënojë kthesë. Sipas njohurive të deritanishme, është duke hulum-

tuar, në formë të thjeshtësuar, se si Hashim Thaçi në funksionin e presidentit të Republikës urdhëroi shërbimin sekret të Kosovës dhe policinë e saj, së bashku me disa institucione të tjera, që të rëmbejnë gjashtë qytetarë të Turqisë dhe t'ua dorëzojnë shërbimit sekret turk në zonën ndërkomëtare të aeroportit të Prishtinës.

Testi i vërtetë, në fakt, shkon tej personalizimit të këtij problemi me Thaçin (ndonëse emri i tij është magnetik për çfarëdo dëmtimi strukturor ekonomik e politik të këtij vendi në së paku dhjetëvjetëshin e kaluar) dhe do të jetë a ka mundësi që Kuvendi i Kosovës ta kryejë funksionin e vet të dukur mbikëqyrës në këtë vend? A ka ndarje pushtetesh në shtet të kapur?

Këtë dilemë të njëjtë, nga një kënd e metoda të tjera, po përpiqen ta trajtojnë, dhe ky është sinjali i dytë, Lëvizja Vetëvendosje me protestën kundër kryeprokurorit të shtetit. Perceptimi opozitar dhe i një pjesë të opinionit publik është se kryeprokurori i shtetit është vënë në shërbim të Hashim Thaçit, në çfarëdo cilësie. Nëse kryeprokurori nuk shihet i ndarë prej funksionit të Hashim Thaçit dhe strukturës së tij jodemokratike e kundërdemokratike (siç u pa me rëmbim të gjashtë qytetarëve) atëherë ose hapet edhe një komision hetimor, ose, siç propozojnë shkurt në LVV, dilemë të protestë.

Ajo që mund të ndodhë në javët në vijim është gara e sinjaleve, e atij brendainstitucional dhe atij jashtainstitucional, një garë që duket se është drejtuar te i njëjti cak, se si të thyhet paradigma e një shteti të kapur.

HOROSKOPI

DASHI

Të lindurit e kësaj shenje kanë nevojë për mbështetje shoqërore ose këshilla. Mund të përballeni me disa probleme të vogla në familje ose në çështjet financiare. Tregoni zgjuarsi dhe fakti në bisedat me më të moshuarit. Ndërsa të afërmit mund të kenë nevojë për vëmendjen tuaj të veçantë.

DEMI

Demët nuk rekomandohen të përfshihen në biseda të gjata. Kjo këshillë ka lidhje mbi të gjitha për ata që mund të diskutojnë me të huajt për jetën personale. Pjesa tjetër e së shtunës do të kalojë mjaft mirë dhe do të ndihni në humor.

BINJAKET

Ka gjasë të ulni ritmin e rrjedhës së ngjarjeve në jetën tuaj. Ky është hapi i duhur pasi do të jeni në gjendje të relaksoheni si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht. Sa i përket marrëdhënies suaj të dashurisë, nuk rekomandohen reforma.

GAFORJA

Bëni kujdes me luhajtjet e humorit. Ekziston mundësia që një udhëtim familjar që kishit planifikuar të anulohet. Ka gjasë të bëni disa blerje të rëndësishme gjatë ditës së sotme duke u përhtatur edhe me dëshirën tuaj për të ndërruar gardëroben. Në fund të ditës mund të kenë vizitorë.

LUANI

Përdorni diplomacinë në gjithçka që dëshironi të arrini sot. Ushtrimet e lodhshme fizike, festat me alkool dhe konfliktet me prindërit duhet t'i shmangni. Në mbrëmje mund t'ju vijë një surprizë mjaft e këndshme në marrëdhënien tuaj të dashurisë.

VIRGJERESHA

Të lindurit e kësaj shenje mund të përballen me probleme në marrëdhëniet personale. Mos i besoni verbërisht personave që ju pretendojnë mbështetje apo ndihmë. Përpiquni t'i analizoni me kujdes bisedat, pavarësisht rëndësisë së tyre.

PESHORJA

Peshoret mund të mësonjë disa lajme të rëndësishme këtë të shtunë. Ka gjasë që kjo të ketë lidhje me një trashëgimi potenciale ose me ndarje të pronave. Ekziston mundësia e një zënkë me një prej familjarëve ose miqtë të ngushtë. Mund të shmangni ato skandal nëse i merrni gjërat me qetësi.

AKREPI

Mos u dorëzoni ndaj provokimeve. Do të kenë një të shtunë të qetë nëse veproni me qetësi dhe nuk ndërmerri vendime të nxitura. Mund të bëni udhëtime të shkurtra, mund të kaloni kohë me miqtë ose të lexoni një libër.

SHIGJETARI

Disa Shigjetarë do të kenë vështirësi në komunikim. Ka gjasë që për një arsye të caktuar partneri/partnerja të refuzojë të flasë me ju. Rekomandohet t'i lini gjërat të rrjedhin natyrisht. Kushtojni vëmendje shëndetit dhe rekomandohet të konsultoheni me një mjek.

BRICJAPI

Disa Bricjapë do të acarohen nga paqëndrueshmëria e kësaj dite. Ka gjasë që plani i mëparshëm për të shtunën të ndryshojë. Ndoshta arsyeja për këtë do të jetë një miku juaj i ngushtë. Duhet të tregoheni fleksibël për t'ju çuar gjërat në vijë.

UJORI

Disa Ujorë do të duhet të zgjidhin një çështje të rëndësishme. Duhet t'i kushtojni shumë kohë jetës suaj personale. Megjithatë do t'ju duhet që të ndihmoni një anëtar të familjes ose të ndiqni një event të lodhshëm.

PESHQIT

Nuk rekomandohet ta kaloni këtë ditë duke udhëtuar. Është shumë e rëndësishme që të ecni dhe të kryeni ushtrime fizike. Nuk është dita e duhur për të bërë ndryshime në shtet. Do të kenë fat nëse vendosni të bëni blerje këtë të shtunë.

Java e 31-të, bëhen llogaritë e para

Tirana duel mbijetese, Skënderbeu dhe Flamurtari për Europën



pret Teutën në një ndeshje që mund të konsolidojë edhe më shumë pozitat e tyre në vendin e dytë. Në stadiumin e Kamzës i sfidon

Teuta, një kundërshtar, që do të përpigjet t'i marrë më të mirën këtij takimi, pasi për durrsakët çdo pikë e lënë i largon edhe më shumë nga zona euro. Ecuria e Teutës në javët e fundit nuk të bën të jesh shumë optimist, por ky takim mund të jetë një pikë kthese për një sezon që

nisi me shumë bujë, por që po shkon drejt dështimit. Një tjetër sfidë direkte për zonën euro zhvillohet Korçë ndërmjet Skënderbeut dhe Flamurtarit. Ekipi i Orges Shehit kërkon të qëndrojë në vallet për një vend në Europë, gjithnjë duke pritur vendimin përfundimtar nga

KAS. Edhe në sfidën e fundit, atë kundër Kukësit, vërtetuan se janë shumë të preکشëm në mbrojtje, por që dinë të luajnë futboll të mirë dhe mund të marrin pikë të plota përballë çdo rivali. Flamurtari kërkon të ruajë ecurinë shumë pozitive këtë periudhë, me apo

pa lekë. Vlonjatët janë një skuadër, e cila pretendon Europën. Në fund, por jo më pak e rëndësishme është sfida që do të luhet në Gjirokastër. Luftëtari pret sërish Tiranën, këtë herë nuk diskutohet më për finalen e Kupës, por për mbijetesë. Kryeqytetasit nuk dëshirojnë të dalin pa pikë nga kjo transfertë, çdo përfundim tjetër do të ndërlikonte edhe më shumë këtë fundsezon, pasi rivali i tyre i drejtpërdrejtë, Kastrioti shijon i qetë dhe pushim tri pikët në tavolinë.



Jeton Selimi

Trajneri i kuq nuk kursen asnjë dhe kërkon të mposhtë ish-shokun e skuadrës, Starovën

Gega: Gjici nuk më intereson, Laçi është ndeshja e radhës

Një përgjigje vjen edhe për presidentin e Kukësit

10 pikë diferencë me vendin e dytë janë shumë në këtë pikë të sezonit, por askush në shtëpinë e kuqe nuk ka ndërmend të festojë për sa kohë matematika nuk ia lejon. Askush nuk ka bërë më mirë se të kuqtë këtë sezon, por as kjo ecuri nuk e zbalancon trajnerin Gega, nuk e ka bërë kurrë diçka të tillë dhe nuk ka ndërmend as ta bëjë përpara sfidës kundër Laçit. Që në momentin kur Partizani nisi të udhëheqë kampionatin, gjithnjë është diskutuar për titull. Presioni ka qenë gjithnjë prezent, fakt të cilin e pranon edhe Gega.

Si e shikoni ju këtë përballje me Starovën?
Partizani nuk është vetëm i Gegës dhe Starovës, në kohë të caktuara mund të jemi në front të ndryshme. Komentet e mia kanë qenë të pakta, përveç mbështetjes. E rëndësishme është që është futboll, edhe karshi vëllait do të doja të fitoja. S'ka asnjë problem kush është te Laçi, thjesht ndeshja e radhës.

Është trajneri i fundit që e ka nxjerrë kampion Partizanin...
S'ka të bëjë trajneri, jemi 2



klube të ndryshme. Jam me fat që jam këtu, kanë qenë ditët më të mira të karrierës sime. Nuk ka përballje perso-

nash, thjesht janë 2 ekipet. Do të shikohen diferencat, jo rastesisht jemi këtu.

A ndikon presioni i titullit tek ekipi?
Është e vërtetë, që në momentin e parë që dolëm të parët, që nga ajo ditë deri sot

jemi pyetur për titullin. Jemi munduar të jemi me këmbë në tokë. Besoj se të çdo futbollist ka një ëndërr të brendshme. Do të marrim atë që kërkojmë dhe nuk kam frikë tek ata, janë stërvitur njësoj. Do t'i shikojmë gjërat me radhë. Është ndeshje e vështirë, do t'i marrim masat. Kemi tifozët, që janë fryëmarrje për ne dhe mendoj se do të jetë numër i madh, sepse po shikojmë drejt fundit.

U frikësohet Gega aleancave?
Nuk kam asnjë argument, asnjë provë që janë bërë. Siç besoj për veten, besoj edhe për të tjerët. Nuk do të merremi me këto gjëra.

Si e shikoni skuadrën?
Futbolli nuk ka shumë sekrete, ka interpretim. Këta

lojtarë janë stërvitur edhe me Starovën, tani i stërvit unë.

Do ta pranoni barazimin?
Nëse vjen, do ta pranojmë. Jam i kënaqur me maksimumin. Nëse loja e tregon, jam i kënaqur.

Ky do të jetë Partizani deri në fund?

Gojt e liga nuk do të mbyllen as me Gegën, as me ikjen e Gegës. Puna dhe rezultatet do ta tregojnë se kush është në rrugën e duhur. Paragjykimet do të ngelen mbrapa shumë shpejt. Do të shikojmë nesër (sot), Laçi është ndeshja kryesore për ne.

Është një nga ndeshjet më delikate deri në fund për shkak të mungesave?
Është e vërtetë që kemi mungesa, çdo javë kemi pasur. Për fat të mirë, ata që kanë zëvendësuar kanë dhënë maksimumin. Të gjithë kanë ndenjur në gatishmëri, edhe nesër i kemi lojtarët.

Kalari do të jetë, nisur edhe nga prezenca e Kalarit në konferencë?

Ishte radha e Kalarit, është "veteran" sepse është i ri nga këmbët dhe zemra. Ndihet i ri, por nuk kemi vendosur. Kalarit luan në çdo vend. Ka eksperiencë dhe e ka të lehtë të modifikohet. I orë përpara ndeshjes do ta vendosim.

Nuk përmendet më Kukësi...

Mbase rivalët kanë ndryshuar drejtim. Ne i kemi respektuar sa herë përmenden. Vazhdojnë të jenë ekip i mirë, i fortë. Nuk duam të lëmë asnjë rival të afrohet. Rivali është vetëm vetja jonë.

Gjici tha se Partizani nuk është as për vend të katërt...

Nuk më intereson. Është president i një klubi që ka pasur një 5-vjeçar të mirë. Unë jam në futboll, ai është biznesmen, është e drejta e tij. Vjet ka dalë Kukësi kampion dhe nuk e di kush i marrë gjynahet e Partizanit. S'kam parë asnjëherë Gaz Demin të flas për ndonjë klub, por i ka mbështet. Këtu funksionojnë të gjitha luvat. Kurse klubet e tjera kanë perceptimet e tjera karshi klubit, karshi meje, sulmuesve tanë, mesfushorëve tanë, me syrin që ata e shohin. Është momenti të mos kthehemi mbrapsht dhe të bëjmë rivalitet në konferenca. Fusha e ka treguar, fusha do ta tregojë.

PRESIDENTI BAVAREZ

Hënes: Kovaç po bën një punë të mirë te Bajerni

Fjalë që nënkuptojnë konfirmimin e Niko Kovaç në stolin e Bajernit të Mynihut edhe për sezonin e ardhshëm, ato që tha Uli Hënes karshi kroatit. "Kur një trajner arrin finalen e DFB Pokal, në sezonin e parë dhe është mes katër të parëve në renditje me 4 javë nga fundi i kampionatit, do të thotë se ka bërë një punë të mirë. Nuk kemi përse të qahemi", ka deklaruar ai për "spox.com", ndërsa më pas shton. "Nuk është ende e qartë pse ka akoma njerëz që e vënë në diskutim. Jemi një pikë sipër Borussia Dortmundit dhe me një golavarazh më të mirë se ata. E dimë se çdo shkarje do të jetë vendimtare, por çdo gjë e kemi ne në dorë. Duhet vetëm të bëjmë atë që po bëjmë. Jam krenar për skuadrën".



Në Spanjë e bëjnë të sigurt


Murinjo rikthehet në verë në stolin e Interit

Zemrën e kam tek Interi" pat thënë pak ditë më parë trajneri portugez, që e riktheu Interin te sukcesi në Champions League pas 45 vitesh mungesë, ndërsa kjo deklaratë dashurie nuk ka ardhur rastësisht në këtë moment që "Special One" është i papunë. Sipas "Don Balon", portugezi do të marrë stolin e Interit, të cilin e la në vitin 2010, pas suksesit të madh për të përfunduar projektin e Real Madridit. Madje jo vetëm kaq, portali spanjoll është i bindur në atë që shkruan, duke shtuar se Mou ka dorëzuar listën e merkatos të drejtuesit zikaltër. Mes afërimeve është edhe Godin, që ka marrë bekimin e Murinjosh, ndërsa portugezi do me çdo kusht edhe Varenen, që kushton 80 milionë euro dhe për të financuar ardhjen e francezit, Interi do të ishte i gatshëm të sakrifikohej Skriniarin. Rikthimi i Kutinjos është një opsion, por më real mbetet pista "Modriç". Sa u takon largimeve, të sigurt janë Miranda dhe Perisic, me kroatin që kërkon prej muajsh të bashkohet me Manchester Junajtidin.

Solskjaer: Pogba qëndron te Manchester Junajtidi

Trajneri i Manchester Junajtidi, Ole Gunnar Solskjaer, flet për një nga çështjet më të nxehta të ditëve të fundit në ekipin e tij, qëndrimin ose jo të mesfushorit francez Pol Pogba me "Djajtë e kuq". Trajneri norvegjez i ka idetë e qarta dhe këtë e thekson dhe në konferencën e fundit për shtyp. "Në futboll asgjë nuk është e garantuar, por besoj se Pol do të qëndrojë. Kjo është ajo që unë mund të them tani për tani. Mund t'ju siguroj se aktualisht është i vendosur që të ketë sukses me Manchester Junajtidin. Ai është një lider si në fushë, ashtu edhe jashtë saj".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Pupi regjisor.
- Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve
- Turner aktore.
- Fillojnë festat.
- Skuadër greke.
- Falen pa fe.
- U shkrua nga Gorkij.
- Një sferë për... model.
- Janë bisha.
- Parashtesë për dy.
- Demoni që persekutonte Sarën.
- Stacion i famshëm orbital.
- Mendes regjisor.
- Një rreth i ngushtë miqësor
- Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
- Këndohen në opera.
- Është lajm i vjetër.
- Sharif aktor.

- Martin i Norma Rae.
- Mund të jenë filmi.
- Një jepet për hartim.
- Ami i Maupassant.
- Fundi i Turandot.
- Haliili këngëtare.
- Neill i Jurassic park.
- Pineda e Garcia Lorca-s.
- Giorgio stilist

VERTIKAL

- Morisette këngëtare.
- Kilmer aktor.
- Heche aktore.
- Fillojnë tatëpjetën
- Është diapoziti shumë i ndjeshëm.
- Mbyllin spitale.
- Në krye të masave.
- Bëjnë shirit me shi.
- Qe vajza e Tantalit.
- Janë më shumë se dëshira
- Ishte dekret i sulltanit.
- Qe mbreti i urtë i Pilos.
- Quinn aktor.

17. Gasol i NBA.

- Fillojnë garën.
- Një pjesë e reformave.
- Është si biskotë.
- Mund të jetë karmelitan.
- Sjellin shi.
- Bei i Maupassant.
- Direk pa ekstreme.
- Cjysma e bimëve.
- Mbyllin një motor.
- Është bitum.
- Fara këngëtare.
- Hanks aktor
- Stiller aktor.
- Morrison rockstar.
- Fillojnë masat.
- Në krye të tabelës.
- Derisa janë në fund.
- Fund filmi.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Film i hitchcock.
- Fillojnë premierën.
- Janë legjendat.
- Kush ka... ka zët.
- Thurman aktore.
- Një pjesë e testamentit
- Një pjesë e studimeve.
- Kështu është situata e tensionuar.
- Telefoni në kartëvizitë.
- Në krye të autoriteteve.
- Mbyllin mbledhjen.
- Pason abetaren.
- Nisin nga kreu.
- Fillojnë aafrimin.
- Cocker këngëtar.
- Bartok kompozitor.
- Triac që qe tenist.

35. Oxa këngëtare.


- Kalimi në ekstreme.
- U shkrua nga Zola.
- Fise pa fe.
- Është mbalomë.
- I mungon apatikut.
- Një pjesë e medaljeve.
- Një këngëtar lirik.
- Pak torturues.
- Ka privilegjin e jetës.
- I famshmi Pacino.
- Nasi shkrimtar.
- Janë temperaturat më të ulëta.
- Me pit në box.
- VERTIKAL**
- Janë enigmatikë.
- Emri i Vivaldit.
- Rrjedh në klepsidër.
- Inicjalet e Selleck aktor.
- Fillojnë rubrikën.
- Ishte babai i Prokinit dhe Filomelës.
- Vitet pa kufij.
- Mbyllin kanate.
- U shit për një pjatë thjerza.
- ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
- Moore aktore.
- Rocca aktore.
- Janë përmasa.
- Fund dhjetori.
- Mbyllin krahum.
- Fillojnë kalimin.
- Duhen ruajtur.
- Ishte Europa komuniste.
- Agjenci Kombëtare Lokale
- Berg kompozitor.
- Të parat në Amsterdam.
- Elsa këngëtare.
- Memoria në computer
- Me të nxjerrin trarë.
- Në mes të dhomës.
- Ekstreme kateti.
- Kufijtë e lutjes.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		7			5				9
					8				
2		5	7	3					
3		9	2	1					
									4
8					9	3			
	7						3		
							9		
	2		8		6				1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	9	4	6	5	8	2	7	3
2	5	7	4	3	9	6	1	8
3	8	6	2	1	7	5	4	9
4	1	2	5	8	3	7	9	6
7	3	9	1	2	6	8	5	4
5	6	8	7	9	4	3	2	1
9	2	5	3	6	1	4	8	7
6	4	1	8	7	5	9	3	2
8	7	3	9	4	2	1	6	5

Argëtim filozofik

- Mos u mundoni për të kuptuar shoqërinë. Ajo duket njerëzore, por ndryshon vazhdimisht fytyrën

- Ka njerëz që sa më shumë të bëni për ta, aq më pak ata bëjnë për veten e tyre.

- Zgjidhni ata që janë duke fjetur dhe jo ata që ëndërojnë ... !!

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	11	18	3	10	18	2	1	15	20
3	2	6	5	3	2	1	5	1	13	1
21		4	3	5	6	2	1	5	10	5
1		6	10	1	2	8	11	6	4	1
2	13	7	2	1	5	1	1	2	8	19
	19	1	7	3	5	6	15	14	10	6A
13	3	5	2		5	6	11	1	1	5T
5	2			21	19	6	2	1	5	1E
1	5	7	6	2	8	5	10	8	6	
16	8	7	8	17	6	5	1	6	21	6
6			15	8	5	1	5		18	3
4	3	18	8	7	6		18	6	4	6

M	A	S	H	U	R	K	A	I	R	A	K
E	S	T	E	R	A	D	H	U	N	A	
I	T	E	A	T	E	R	M	I	N		
E	R	A	P	O	L	A	R	T	A		
K	E	L	P	O	L	E	M	I	K	A	T
L	P	O	L	I	G	A	M	I			
E	T	A	P	I	K	A	T	R	E	L	
K	O	M	O	D	E	N	T	O	K	E	
T	R	I	S	E	T	M	N	U	N		
I	T	T	U	T	U	I	T	I	D		
K	A	D	E	T	K	O	S	H	L	E	
E	T	I	K	S	E	K	S	E	R	E	T

Thënie të mençura

- Gjysma e punës është mbaruar kur ajo fillohet me dëshirë.
- Njeriu i lirë është ai i cili nuk ka frikë për të shkuar deri në kufirin e logjikës së tij.
- Bëjini sytë katër para martesë, dhe mbajini gjysmë mbyllur pas martesë.
- Mos lejoni që valët të të nxjerrin atje ku ato duan. Shih si lëvizin, dhe harto drejtimin tënd.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIEVE TË NUMRIT TË KALUAR

P	E	T	R	I	K	A	A	S	P	A	K
T	R	U	P	T	A	L	E	N	T	I	A
B	E	L	S	A	N	D	O	K	A	N	
B	A	K	U	N	I	N	A	N	E	M	I
T	A	M	A	R	O	C	I	I	H		
P	T	E	N	E	A	O	D	R	E		
A	G	T	O	N	E	K	A	L	O	S	
R	A	T	K	E	M	A	D	E	A	L	M
K	E	L	S	A	P	E	T	E	E	A	P
E	L	S	A	V	A	L	L	R	O	N	E
R	I	T	M	A	L	L	A	R	M	E	T

FJALËKRYQI (1)

Argëtim filozofik



FJALËKRYQI (2)

